

RAPORT FINAL

MBI

ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË KOMBINUAR (PËRPUTHSHMËRIE DHE FINANCIAR) TË VEPRIMTARISË NË SHËRBIMIN PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAVE

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA), funksionon në zbatim të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në MB”, si dhe akteve të tjera ligjore, nënligjore e normative të dala në zbatim të tij, akte të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e njësisë shpenzuese SHÇBA, rregullohen sipas VKM nr.829, datë 03.12.2014 “Për miratimin e Rregullores së SHÇBA, në MPB”.

Struktura dhe organika e këtij institucioni, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm, (neni 11 i ligjit nr.70/2014 “Për SHÇBA”. Për periudhën e audituar, nga 01.01.2018 deri më 01.11.2018, struktura është e miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.55, datë 21.03.2017 “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe përbërjen organike të SHÇBA” dhe për periudhën nga 01.11.2018 deri më 18.11.2019, struktura është miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.579, datë 26.10.2018. Nga 18.11.2019 e ne vazhdim, struktura dhe organika e këtij institucioni janë në zbatim të urdhrin nr.581 datë 12.11.2019.

Objektivat kryesore të SHÇBA, janë :

- Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale e shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës.
- Inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave, sipas standarteve të miratuara me akte normative.
- Ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave.
- Verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve ka ankesa e kallzime.
- Analiza, studime e rekomandime mbi bazën e inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e funksionimit të strukturave, etj.

Në mënyrë të përmbledhur, nga auditimi i veprimtarisë së kësaj organizate sipas çdo tematike të miratuar në programin e auditimit rezulton si më poshtë:

Në auditimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se, nga 14 rekomandimet e lëna në auditimin e fundit të kryer për periudhën deri më 31.12.2017, përfshirë edhe rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme e të pazbatuara, struktura menaxhuese e SHÇBA, ka realizuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht ose në proces realizimi 5 rekomandime dhe nuk janë realizuar 4 rekomandime. Gjithashtu nga insitucioni, nuk është caktuar një punonjës për komunikuar, monitoruar dhe informuar, për progresin e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me pikën 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” të MAB.

Moszbatimi i rekomandimeve, të gjitha të pranuar nga Institucioni, është në kundërshtim me nenin 9, pika 2 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi titullarët e institucionit sipas periudhave si dhe personat e ngarkuar në planin e veprimit për zbatimin e tyre.

Në auditimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, rezultoi se, njësia publike, në kuadrin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me gjithë përmirësimet e bëra nuk ka arritur që të krijojë një mjedis të plotë kontrolli. Që nga viti 2014 e në vazhdim, ka patur ndryshime e përmirësime të strukturës dhe organikës, por edhe ndryshime ligjore të cilat nuk janë reflektuar në rregulloren e brendshme të veprimtarisë së këtij institucioni.

- Nuk është miratuar me urdhër të brendshëm të titullarit të njësisë publike, ngritja e grupit të menaxhimit strategjik, (GSM), si dhe nuk është përcaktuar kordinatori i riskut të njësisë publike (personi përgjegjës) për bashkërendimin e veprimtarive të drejtorive, sektorëve e zyrave, që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve si dhe për raportimin e përgjithshëm të risqeve të institucionit të titullari.

- Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të pasqyrohen objektiva të qarta lidhur me misionin që ka ky institucion, vlerësimi dhe kontrolli i rrisqeve në arritjen e objektivave. Nga ana e strukturave operacionale dhe strukturave të tjera të institucionit, nuk është implementuar akoma Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Institucioni nuk ka arritur të kryejë aktivitetin e kontrollit të brendshëm në vazhdimësi dhe në mënyrë të plotë, në të gjitha hallkat menaxhuese, kjo pasqyrohet te moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna dhe i gjetjeve të konstatuara gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit. Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenet 9, 10, 11 dhe 18, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi strukturat menaxhuese të njësisë publike dhe nëpunësin autorizues.

Në auditimin e buxhetit rezultoi se, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, është i bazuar në akte ligjore, nënligjore e normative. Më mirë duhet të punohet në drejtim të realizimit të buxhetit, në veçanti për zërin e shpenzimeve “Mallra e shërbime”.

Në auditimin e procedurave ligjore për prokurimin e fondeve, realizimin e kontratave dhe procedurat e blerjes me vlera të vogla, rezultoi se nuk ka urdhër të AK për përcaktimin në fillim të vitit të personit përgjegjës, për prokurimet publike dhe dërgimin e emrit pranë APP, në kundërshtim me nenin 57, të VKM nr.914, datë 29.12.2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar, pika 1, ngarkon me përgjegjësi titullarët sipas periudhave.

- Për vitin 2018, në regjistrin e realizimit të prokurimeve, i printuar nga sistemi elektronik i APP, nuk janë hedhur dy procedurat e prokurimi, blerje bojra, tonera me vlerë 1,666,667 lekë (pa tvsh) dhe blerje automjete me vlerë 27,500,000 lekë (pa tvsh) të parashikuara në regjistrin e parashikimit, të realizuara nga ABP në MB, në kundërshtim me udhëzimin nr.1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit publik dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, përgjegjësi e titullarit të AK dhe personit përgjegjës për sistemin për vitin 2018.

Në auditimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rezultoi se 8 punonjës (4 punonjës me gradë dhe 4 punonjës pa grada) janë liruar nga detyra dhe nuk kanë marrë fletëshkëputjen, ndërsa 4 punonjës (2 punonjës kanë pezulluar statusin e nëpunësit civil, 1 punonjëse liruar me vendim të DAP dhe 1 punonjëse pezulluar nga shërbimi civil) nuk kanë dorëzuar detyrën me proces verbal përkatës, në kundërshtim me pikën 13 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe me nenet 42 e 43 të VKM nr.829, datë 03.12.2014 “Për miratimin e rregullores së SHÇBA në MB”, mban përgjegjësi struktura e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e urdhrave të emërimeve e largimeve të punonjësve.

- Në fund të vitit 2019, organika e miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.581, datë

12.11.2019 me 139 punonjës është e plotësuar me 126 punonjës, pa u plotësuar 12 pozicione. Në auditimin e pagave dhe të ardhurave të tjera të personelit, rezultoi se, nga 29 punonjës të trajtuar me pagesë për kompesimin e shpenzimeve të udhëtimit 9 punonjës (7 të emëruar për herë të parë dhe 2 punonjës si rezultat i ristrukturimit), kanë përfituar trajtimin financiar në shumën 1,117,017 lekë. Në muajin Nëntor të vitit 2019, është bërë ndërprerja e përfitimit të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 9 punonjës të shërbimit. Nga analiza e bazës ligjore që normon këtë shpenzim, ligji nr.70/2014 “Për SHÇBA”, VKM nr.776 datë 19.11.2014, “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 1, udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr.675 datë 05.12.2014, “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e pagesës për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 2 “Kategorizimi i përfitimeve”, nënpika 2.1 dhe VKM nr.829 datë 03.12.2014, “Për miratimin e Rregullores së SHÇBA në MPB”, neni 83, pika 7 rezultojnë se në asnjë nga këto akte, nuk përcaktohet që punonjësit e shërbimit që janë emëruar për herë të parë apo punonjësit që për shkak ristrukturimit të institucionit, ju hiqet e drejta e përfitimit të pagesës për kompensimin e shpenzimeve.

- Punonjësit që kanë përfituar trajtimin financiar për largësi kanë sjellë të gjithë dokumentacionin justifikues në datën e fillimit të trajtimit me largësi (vërtetimin e lëshuar nga njësia administrative për vendbanimin, certifikata familjare, etj) dokumentacioni i cili nuk është rifreskuar deri në fund të vitit 2019.

- Janë trajtuar me pagesë kalimtare 15 punonjës, (3 ish punonjës janë trajtuar me diferencë page për shkak të punësimit në struktura të tjera shtetërore, 11 ish punonjës të cilët janë liruar me kërkesën e tyre dhe 1 punonjëse me motivacionin “Djegur dekonspiruar”). Në urdhrat e largimit, për punonjësit që përfitojnë pagesën kalimtare është miratuar pagesa me dy paga mujore dhe më pas, trajtimi është bërë me 50% të pagës neto. Është përcaktuar periudha kohore e trajtimit të punonjësve për aq muaj sa vite pune ka (sipas vjetërsisë së shërbimit) dhe jo sipas përcaktimit ligjor të nenit 12, pika 1,2 dhe 3 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, përgjegjësi e strukturës menaxhuese të institucionit.

- Për periudhën e audituar, nga 719 autorizime të nxjerra nga Drejtori i Shërbimit “Për angazhim me shërbim të punonjësve të SHÇBA jashtë vendbanimit të tyre”, janë protokolluar, pas kryerjes së shërbimit nga punonjësit 456 autorizime ose 63% e tyre.

Në auditimin e sistemit të pagesave me bankë, rezultoi se janë likuiduar me urdhër shpenzimet nr.215, 216, 217, 218 219, datë 11.10.2019, gjoha në shumën 25,000 lekë, për deklarim të vonuar të punëmarrësve të rinj në vitet 2017 dhe 2019, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH” i ndryshuar, përgjegjësi e nëpunësit autorizues sipas periudhave.

- Në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.3419, datë 13.07.2017, me USH nr.235, datë 28.10.2019 është likuiduar përmbaruesi privat “Kodra Bailif Service shpk”, në shumën 292,628 lekë ku përfshihen edhe shpenzimet përmbarimore 26,400 lekë të likuiduara. Likuidimi është bërë pa patur faturën tatimore, (likuidimi datë 28.10.2019 fatura datë 01.11.2019), në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 61 e tij dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues.

- Për likuidimin e katër vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerë 2,752,548 lekë, është bërë gjurma e auditimit sipas formatit tip, por nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative para likuidimit të këtyre vendimeve, në kundërshtim me pikën 62 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe pikën 38 të Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, përgjegjësi e nëpunësve zbatues e autorizues sipas periudhave.

Në auditimin për mbajtjen dhe funksionimin e sistemit kontabël, rezultoi se në llogarinë “Debitorë të ndryshëm”, është një vlerë prej 295,435 lekë, që janë detyrimet debitore të 8 personave privatë. Për këto 8 persona, për vitin 2018, nuk është arkëtuar asnjë vlerë. Nga këto persona, për 5 prej tyre (4 punojnë në SHISH dhe 1 në Polici), janë dërguar shkresa zyrtare por nuk është marrë përgjigje. Për 3 persona janë dërguar shkresat në qendrën e banimit, por nuk është marrë përgjigje. Edhe për vitin 2019, nuk është arkëtuar asnjë vlerë debitore, por është shtuar vlera debitore për 294,369 lekë për 2 persona.

- Komisioni i inventarizimit të aktiveve, i përbërë nga 3 veta, ka përfunduar inventarizimin me datën 11.02.2019. Raportin lidhur me kryerjen e inventarizimit e ka dërguar tek nëpunësi autorizues, me prot. nr.61/3, datë 13.07.2019, pra pas pesë muajsh, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, i ndryshuar pika 85, germa „c“ dhe ngarkon me përgjegjësi tre anëtarët e komisionit.

- Vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor prej 221,484 lekë, përfaqëson vlerën e mbetur të pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiVViFi“ me vlerë fillestare 700,000 lekë. Nga dokumentacioni që disponon institucioni, nuk vertetohet që kjo pasije ka dalë në përdorim. Vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor, nuk është e saktë.

Në auditimin mbi organizimin dhe funksionimin e llogarive të sektorit material në shërbimin e veshmbathjes, rezultoi se punonjësit janë trajtuar me veshmbathje një herë në vit, sa masa e një pagë mujore bruto. Për vitin 2018, kanë përfituar 115 punonjës në vlerën 10,061,894 lekë dhe për vitin 2019, kanë përfituar 126 punonjës në vlerën 11,183,932 lekë. Në total për dy vitet kanë përfituar vlerën 21,245,826 lekë, për të cilën nuk është mbajtur tatimi në burim në masën 15% në shumën 3,186,873 lekë, në kundërshtim me nenin 8 pika 1/a, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me nenin 2 të ligjit nr.156/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me pikën 2.3 “Të ardhurat e tatueshme” të Udhëzimit të MF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Për këtë veprim kanë përgjegjësi nëpunësit autorizues sipas periudhave dhe nëpunësi zbatues.

- Fletëhyrjet e armatimit e municionit, nuk kanë numër rendor të saktë pasi janë dubluar numrat, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 e tij, ka përgjegjësi specialisti i armatimit. Libri i shpërndarjes së armatimit në efektiv nuk është firmosur në tre raste nga tre punonjës që janë në marrëdhënie pune dhe në tre raste të tjera nga tre punonjës të larguar nga puna të cilët kanë bërë dorëzimin e armatimit dhe municionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e formatit të miratuar, përgjegjësi e specialistit të armatimit.

II. HYRJE

Raporti Final i Auditimi u hartua në MB, në përfundim të angazhimit të auditimit të kombinuar (përputhshmërie dhe financiar) në njësinë shpenzuese SHÇBA, për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri më 31.12.2019.

Auditimi u krye në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, planit vjetor të punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Brendshëm me shkresën prot. nr.562, datë 30.10.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020”, Autorizimit të Drejtuesit të DAB “Për përgatitjen e angazhimit të auditimit” nr.47, datë 06.01.2020, dhe programit të angazhimit nr.47/2, datë 10.02.2020 “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në SHÇBA”.

Qëllimi i auditimit, ishte shqyrtimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së këtij institucioni, dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të drejtimit të Institucionit, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, për një përdorim efektiv e transparent të fondeve e burimeve në përdorim të këtij institucioni.

Objektivi i auditimit ishte të sigurohet menaxhimi mbi nivelin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij institucioni dhe të japim rekomandimet me qëllim për të ndihmuar organizatën në realizimin e objektivave dhe përgjegjësiive tij.

Fillimisht në datën 17.01.2020, grupi auditimit realizoi me organizatën takimim e prezantimit i dokumentuar nëpërmjet formularit standard nr.7, “*Takimi fillestar me organizatën*”. Në këtë takim u ra dakort për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri me 31.12.2019, fushat që do të auditohen, linjat e komunikimit etj.

Sipas pikave të projekt programit dhe fushave të identifikuar për auditim, u krye vlerësimi i riskut për këto fusha/sisteme. Pas kombinimit me vlerësimin e riskut për mjedisin e kontrollit, rezultoi vlerësimi i riskut të përgjithshëm “*I mesëm*”.

U përgatit programi i punës për auditim të kombinuar, (përputhshmërie e financiar) në këtë organizatë, cili u miratua me shkresën prot. nr.47/2, datë 10.02.2020. Nga audituesit u kryen teste të ndryshme duke vlerësuar efektivitetin e tyre në sistemin e kontrollit. Gjatë misionit të auditimit, grupi i punës, diskutoi me personelin përgjegjës për gjetjet e konstatuara për të cilat do të jepen edhe rekomandimet për përmirësim të sistemeve, gjetje të cilat janë të argumentuara mbi bazën e evidencave mbështetëse të ekzaminuara nga audituesit.

Raporti Final i Auditimit mbahet mbi bazën e dokumentacionit të audituar në këtë njësi shpenzuese dhe diskutimeve me personelin përgjegjës për gjetjet e konstatuara. Gjithashtu Raporti Final mbahet mbi bazën e Projekt Raportit të Auditimit, dërguar në institucionin e SHÇBA nga DAB me shkresën nr.47/3 datë 06.03.2020 dhe kthimin e përgjigjes nga organizata me shkresën nr.593/1 datë 16.04.2020. Bashkëlidhur kësaj shkrese, janë observimet e bëra nga organizata e audituar, për të cilat trajtimi bëhet në kapitujt vijues të këtij materiali.

III. METODA E AUDITIMIT

Shërbimi i siguriës, nëpërmjet auditimit të kombinuar dhe vlerësimi i veprimtarisë së këtij Institucioni, u krye nga auditët e DAB në MB Hamdi Çobaj dhe Natasha Uruçi. Auditimi u krye nga data 17.01.2020 deri më datën 21.02.2020. Periudha e përfshirë në auditim ishte nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2019.

Për të kryer këtë angazhim auditimi u përdorën metodat “*Testim hap pas hapi*” e kombinuar me metodën e intervistimit dhe atë të përdorimit të pyetësorëve.

Referuar vlerësimit të përgjithshëm të riskut gjatë hartimit të planit vjetor të punës i cili ka rezultuar “*I mesëm*”, është bërë vlerësimi i riskut për fushat përkatëse të llogarisë duke përdorur formularët standard nr.4 dhe nr.5 në zbatim të Manualit të Auditimit të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “*Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm*”. Për realizimin e këtij auditimi u përdor teknika e sondazheve me përzgjedhje sipas gjykimit profesional dhe përzgjedhjes rastësore duke ekzaminuar proceset përfaqësuese të veprimtarisë së këtij institucioni për periudhën nën auditim. Auditimi u krye sipas standarteve të miratuara për auditime brendshëm në sektorin publik.

IV. GJETJET DHE KONKLUSIONE

1. Auditimi i zbatimi të rekomandimeve të lëna në përfundimet e auditimeve të mëparshme.

Verifikimi i marrjes në shqyrtim të konkluzioneve të auditimit të mëparshëm.

Verifikimi nëse ka të përgatitur plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve dhe arkëtimin e detyrimeve me persona konkretë dhe afate kohore.

Verifikimi mbi vënien në dijeni të realizimit të rekomandimeve, në mënyrë të herëpashërëshme në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme.

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MB, është ushtruar auditim në institucionin e SHÇBA, për aktivitetin e periudhës nga 01.01.2017 deri me 31.12.2017. Përfundimet e këtij auditimi, së bashku me Raportin Final të Auditimit, janë dërguar me shkresën e DAB në MB, nr.1563/5, datë 05.02.2018 “*Dërgim i Raportit Final të Auditimit*”, protokolluar në institucion me nr.129/3, datë 16.04.2018. Në Raportin Final, janë lënë për zbatim 12 rekomandime. Në rekomandimin nr.1, janë lënë për t’u zbatuar rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme dhe që kanë rezultuar të pazbatuara deri në kohën e kryerjes së auditimit, gjithsej 7 rekomandime, pra në total për t’u zbatuar gjithsej 18 rekomandime. Theksojmë se të gjitha rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit, janë të pranuar nga subjekti i audituar.

Nga ana e SHÇBA, është përgatitur Plani i Veprimit duke përcaktuar personat përgjegjës, afatin e zbatimit të rekomandimit por nuk është përcaktuar personi të cilit do t’i raportohet për zbatimin e rekomandimit, veprim në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, pika 4.1.13.1 “*Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit*”.

Një kopje e Planit të Veprimit, është dërguar në DAB në MB, me shkresën nr.858/1 datë 04.05.2019. Institucioni, ka raportuar në lidhje me zbatimin e rekomandimeve pranë DAB, (në përgjigje të shkresës së DAB nr.1563/8 datë 15.01.2019), me shkresën nr.91/1 datë 24.01.2019, shkresë në të cilën është informuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Insitucionit, nuk është caktuar një punonjës për komunikuar, monitoruar dhe informuar, për progresin e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me pikën 4.1.13.3 “*Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB*” të MAB, ku përcaktohet që Drejtuesi i njësisë së audituar, duhet të caktojë një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm, të komunikojë, të monitorojë dhe të informojë vazhdimisht mbi zbatimin e rekomandimeve, deri në zbatimin e plotë të tyre.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, të cilat nuk kanë qënë të zbatuara deri në kryerjen e auditimit të fundit, rezultoi si më poshtë :

Rekomandim nr.1: Menaxhimi i lartë i organizatës, të marrë masat e duhura dhe në afat për analizimin e shtatë rekomandimeve të pa zbatuara, të hartojë e miratojë planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve duke përfshirë në të edhe rekomandimet e pazbatuara (të trajtuar në pikën e parë të programit), duke përcaktuar afate dhe persona përgjegjës konkret për zbatimin e tyre dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e sistemeve në vijim. Menaxhimi i lartë i organizatës të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB.

Shtatë rekomandimet e pazbatuara, janë realizuar si më poshtë :

1. Rekomandimi: “Menaxhimi i SHÇBA, të bashkëpunojë me organin qendror, i cili bën akordimin e fondeve dhe të reklamojë fondet e akorduara më tepër, në mënyrë që në fund të vitit ushtrimor, të mos ketë vlera të larta të fondeve të perealizuara”.

Ky rekomandim është zbatuar. Për periudhën e audituar, vitet 2018 dhe 2019, realizimi i buxheteve vjetore të SHÇBA është në masën të kënaqshme.

2. Rekomandimi: “SHÇBA, të hartojë regjistër parashikimi dhe realizimi të prokurimeve publike duke specifikuar objektin konkret të prokurimit, vlerën përkatëse të parashikuar dhe të prokuruar dhe llojin e procedurës së prokurimit, konform Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik”.

Ky rekomandim në proces zbatimi. Për vitet 2018 dhe 2019, janë dërguar regjistrat e parashikimit në fillim të vitit dhe me ndryshime deri në muajin Qershor për vitiun 2018. Në regjistrat e parashikimit në fillim të vitit 2018 e 2019 janë specifikuar objekti i prokurimit, vlera, procedura e prokurimit dhe periudha e prokurimit.

3. Rekomandimi: “Likuidimi i vendimeve gjyqësore të bëhet vetëm pas plotësimit të gjurmës së auditit për nxjerrjen e përgjegjësiive administrative”.

Ky rekomandim është në proces zbatimi. Për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga ana e institucionit, është përpiluar gjurma e auditimit sipas formatit tip të miratuar, por nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative.

4. Rekomandimi: “Menaxhimi i lartë i organizatës të marrë masa për plotësimin e organikës dhe strukturës së SHÇBA sipas urdhrat të Ministrisë të Punëve të Brendshme”.

Ky rekomandim është në proces zbatimi. Organika e institucionit, ka pësuar ndryshime gjatë viteve të përfshira në auditim. Aktualisht organika e këtij institucioni, është e pa plotësuar për 12 pozicione.

5. Rekomandimi: “Menaxhimi i lartë i organizatës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Përafrimit të Legjislacionit në MPB, të iniciojnë përgatitjen e një udhëzimi për interpretimin e VKM për trajtimin e punonjësve me pagë kalimtare. Ky Udhëzim të jetë unifikues për të gjithë programet e MPB”.

Ky rekomandim nuk është zbatuar. Për periudhën e audituar (vitet 2018 e 2019), nga ana e institucionit, nuk janë bërë kërkesa zyrtare ose nuk është iniciuar përgatitja e një udhëzimi, për interpretimin e pagës kalimtare.

6. Rekomandimi: “Menaxhimi i lartë i organizatës, sektori i buxhet financës, të regjistrojë si detyrim debitor vlerën e tatimit në burim për çdo person sipas pasqyrës në Raportin Final të Auditimit. Për vlerën e tatimit në burim prej 3,046,057 lekë, institucioni të kërkojë rrugët ligjore dhe të marrë masa për arkëtim për llogari të buxhetit të shtetit (Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë). Nëse nuk jeni dakort me rekomandimin, menaxhimi i lartë i Institucionit Tuaj, të kërkojë interpretim ligjor nga Drejtoria Juridike dhe e Përafrimit të Legjislacionit në MPB dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e Taksave në Ministrinë e Financave”.

Ky rekomandim në proces zbatimi. Për vitet buxhetore 2018 dhe 2019, është bërë trajtimi me kompensim uniforme me nga një page mujore bruto dhe për këtë përfitim nuk është mbajtur tatimi në burim. Ka korespondencë shkresore nga SHÇBA me Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit në MB, por nuk ka korespondencë nga ky institucion me Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve e Taksave në MF.

7. **Rekomandimi:** “Menaxhimi i lartë i organizatës, (sektori i buxhet financës), të marrin masa për gjetjen e adresave për personat debitorë dhe të bëjnë arkëtimin e vlerës debitorë prej 31,592 lekë për llogari të buxhetit”.

Ky rekomandim është *në proces zbatimi*. Për tre personave debitorë, me vlerë detyrimi 31,592 lekë që nuk kanë patur adresë, (Veap Aga 20,592 lekë, Donald Aliçkaj 5,500 lekë dhe Klodiana Zebi 5,500 lekë), janë gjetur adresat, janë dërguar shkresa me të cilat është kërkuar arkëtimi i detyrimit por deri në përfundim të auditimit, nuk është bërë asnjë arkëtim.

Në auditimin e fundit, janë lënë 11 rekomandime, të cilat janë zbatuar si më poshtë :

Rekomandimi nr.2. Menaxhimi i lartë i organizatës, të mos kryejë likuidime të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimet Gjyqësore të formës së prerë, pa përpiluar më parë gjurmën e auditimit dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative. Të marrë masat që sipas fondeve të akorduara disponibël të kryjë vullnetarisht likuidimin e vendimeve pa ndërmjetësimin e zyrtarëve përmbartës dhe të ndjekë radhën e paraqitjes së vendimeve.

Ky rekomandim është *në proces zbatimi*. Për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga ana e institucionit, është përpiluar gjurma e auditimit sipas formatit tip të miratuar, por nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative.

Rekomandim nr.3: Menaxhimi i lartë i organizatës, të punojë në drejtim të gjetjes së adresave të personave debitorë ndaj buxhetit. Për personat debitorë që janë dërguar shkresat zyrtare dhe nuk është marrë përgjigje për pranimin ose jo të vlerës debitorë, të ripërsëriten kërkesat zyrtare për marrjen debitorë të tyre.

Ky rekomandim është *në proces zbatimi*. Për tre personave debitorë, me vlerë detyrimi 31,592 lekë që nuk kanë patur adresë, (Veap Aga 20,592 lekë, Donald Aliçkaj 5,500 lekë dhe Klodiana Zebi 5,500 lekë), janë gjetur adresat, janë dërguar shkresa me të cilat është kërkuar arkëtimi i detyrimit por deri në përfundim të auditimit, nuk është bërë asnjë arkëtim.

Rekomandimi nr.4. Nga ana e titullarit të institucionit me urdhër të brendshëm të krijohet grupi i menaxhimit strategjik (GMS). Në këtë urdhër të përcaktohet personi përgjegjës si kordinator i riskut, i cili pas identifikimit të risqeve nga grupi menaxhimit strategjik të bashkrendojë veprimtarinë që lidhet me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve si dhe ndjekë e raportojë te titullari hap pas hapi kontrollin e tyre.

Ky rekomandim *nuk është zbatuar*. Nga ana e SHÇBA, nuk është krijuar grupi i menaxhimit strategjik (GSM).

Rekomandimi nr.5. Nga ana e GSM, të merren masat që të krijohet regjistri i përmbledhur i riskut si dhe plani i zhvillimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i cili duhet të përmbaj, objektivin e riskut sipas sektorëve, riskun e identifikuar, kontrollet ekzistuese, vlerësimi pas kontrollit, nevoja për kontrolle të tjera, adresimi i boshllëqeve, zotëruesi i riskut etj. Të përfshijë në regjistrin e riskut edhe risqet e identifikuara nga auditimi i brendshëm referuar gjetjeve dhe rekomandimeve përkatëse të auditit.

Ky rekomandim *nuk është zbatuar*. Nuk është krijuar grupi i menaxhimit strategjik dhe nuk është krijuar regjistri i riskut, përveç sektorit të financës që ka krijuar regjistrin e riskut për këtë sektor.

Rekomandimi nr.6. Sektori i buxhet financës të SHÇBA, të regjistrojë si detyrim debitor vlerën e tatimit në burim të pa mbajtur punonjësve për kompensimin në vlerë të uniformës për vitet 2015 - 2017 në shumën 4,562,109 lekë (3,046,057 lekë i përkasin vitit 2015 - 2016 dhe 1,516,052 lekë vitit 2017). Të ndjekë rrugët ligjore dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës për llogari të buxhetit të shtetit.

Ky rekomandim *nuk është zbatuar*. Për vitet buxhetore 2018 e 2019, është bërë trajtimi me kompensim uniforme me nga një page mujore bruto dhe për këtë përfitim nuk është mbajtur tatimi në burim. Ka korespondenca shkresore e ndjekur mes SHÇBA dhe Drejtorisë Juridike dhe e Përafrimit të Legjislacionit në MB por nuk ka korespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në MEF.

Rekomandimi nr.7. Nga ana e drejtorit të shërbimeve të brendshme dhe e specialistit të armatimit, të merren masat e mëposhtme;

7/1-Të hapet regjisti i llogarisë mod.28, në të cilin të bëhet regjistrimi i të gjithë dokumentacionit hyrje e dalje i armëve e municionit. Pas regjistrimit të dokumentacionit të lëvizjes së armëve e municionit të bëhet rakordimi i llogarisë për shumën e përgjithëshme të armëve e municionit, gjendjes në magazinë dhe armëve në përdorim nga efektivit.

7/2- Drejtori i shërbimeve mbështetëse të bëjë kontrollin nëpërmjet nënshkrimit prej tij të të gjitha fletë daljeve të armatimit të nënshkruara vetëm nga magazinieri dhe të kërkojë pas verifikimit të armës me të dhënat e fletë daljes nënshkrimin e personelit që ka marrë armën dhe municionin në përdorim.

7/3-Nga ana e specialistit të armatimit të merren masat që për të gjithë punonjësit e paisur me armatim e municion të administrohet bashkëlidhur kartelës urdhërat e titullarit të institucionit për furnizimin e punonjësit me armatimin dhe municionin përkatës si dhe të bëhte plotësimi i kartelës me të gjitha të dhënat që përmban kartela sipas urdhrit të titullarit për emërimin e punonjësit dhe urdhrit për paisjes me armë të punonjësit.

7/4-Nga ana e titullarit të institucionit të krijohet menjëherë me urdhër të brendshëm komisioni për inventarizimin fizik të armatimit e municionit në administrim nga SHÇBA. Komisioni i inventarizimit pas rakordimit kontabël të marrë në fletë inventarizimin fizik të armëve edhe nënshkrimin e mbajtësit të armës dhe municionit.

Ky rekomandim *është zbatuar*. Është hapur dhe është sekretuar regjistri mod.28, në të cilin janë regjistruar të gjithë dokument e lëvizjes së armatimit dhe municionit.

Për periudhën e audituar, dokumentet e daljes së armatimit e municionit, përveç magazinierit dhe marrësit në dorëzim, janë të nënshkruara nga drejtori i shërbimeve mbështetëse.

Për kartelat e marrjes në dorëzim të armatimit, rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi nga auditimi i kryer, rezultoi se gjashtë punonjës, nuk kanë firmosur në librin model 35.

Është kryer inventarizimi në vitin 2019 dhe për vitin 2020, ka filluar inventarizimi, me urdhrin e titullarit nr.4 datë 21.01.2020, “Mbi kryerjen e inventarizimit të magazinës për armatimin”.

Rekomandim nr.8: Komisioni i ngritur për përgatitjen e projekt buxhetit vjetor dhe projekt programit buxhetor afatmesëm, të përcaktojë nivelin e realizimit faktik të vitit të fundit buxhetor dhe të nevojave reale për fonde, sipas artikujve të shpenzimeve, duke bërë të mundur shmangien e mosrealizimeve të buxhetit vjetor të planifikuar.

Ky rekomandim *është zbatuar*. Me urdhrat e titullarit nr.565 datë 05.04.2017 dhe nr.785 datë 20.04.2018, janë ngritur grupet e punës të cilët kanë përcaktuar nivelin e realizimit faktik të vitit të fundit buxhetor dhe nevojat për fonde, për të dy vitet e përfshira në auditim.

Rekomandimi nr.9. Nga ana e njësisë së prokurimit në SHÇBA, të merren masat që regjistri i parashikimi dhe realizimi të prokurimeve publike të hartohet duke specifikuar objektin konkret të prokurimit, vlerën përkatëse të parashikuar dhe të prokuruar dhe llojin e procedurës së prokurimit, konform Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrimit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik”.

Ky rekomandim *në proces zbatimi*. Për vitin 2018 është dërguar regjistri i parashikimit në fillim të vitit dhe me ndryshime deri në muajin Qershor 2018 ndërsa regjistri i realizimit nuk

është dërguar në organin qendror. Në regjistrat e parashikimit në fillim të vitit 2018 e 2019 janë specifikuar objekti i prokurimit, vlera, procedura e prokurimit dhe periudha e prokurimit.

Rekomandimi nr.10. Nga ana e komisionit të ngritur për pritjen dhe marrjen në dorzim të mallrave e shërbimeve të kontraktuara, të merren masat që në procesverbalin përkatës të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve të përshkruhen të dhënat e OE që ka sjellë mallin, dokumentacionin shoqërues të mallit dhe ky procesverbal të nënshkruhet edhe nga përfaqësuesi i OE që ka bërë furnizimin.

Ky rekomandim ***është zbatuar***. Nga komisioni i pritjes së mallit, i ngritur me urdhrat e titullarit për çdo blerje, janë përpiluar proces verbalet e pritjes së mallit, në prani të përfaqësuesit të OE që kryen furnizimin.

Rekomandimi nr.11. Menaxhimi i organizatës të marrë masa që për punonjësit që lirohen dhe emërohen të përpilohet urdhërdorëzimi dhe proces verbali përkatës i dorëzim/marrjes së detyrës.

Ky rekomandim ***nuk është zbatuar***. Nga auditimi i kryer, rezultoi se vetëm në një rast (largimi dhe zëvendësimi i magazinierit është me procesverbal) dhe në asnjë rast tjetër nuk është bërë dorëzimi dhe marrja në dorëzim e detyrës.

Rekomandimi nr.12. Menaxhimi i lartë i organizatës të marrë masa për plotësimin e organikës dhe strukturës së SHÇBA konform strukturës dhe organikës së miratuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm.

Ky rekomandim është ***në proces zbatimi***. Për periudhën e përfshirë në auditim, ka patur shtesa në organikën e institucionit, ka patur largime dhe emërimë, por organika e institucionit në fund të vitit 2019 nuk është e plotësuar për 13 vende.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se ka përsëritje, pasi janë rekomandime në fund të kryerjes së auditimit për vitin 2017, të cilat janë të lëna më parë e të pazbatuara. Konkretisht, ka përsëritje në katër raste, rekomandimi nr.2 i lënë në fund të vitit 2017 dhe nr.3 për rekomandimet e pazbatuara, rekomandimi nr.3 i lënë në fund të vitit 2017 dhe nr.7 për rekomandimet e pazbatuara, rekomandim nr.6 i lënë në fund të vitit 2017 dhe nr.6 për rekomandimet e pazbatuara dhe rekomandim nr.12 i lënë në fund të vitit 2017 dhe nr.4 për rekomandimet e pazbatuara. Në përfundim nga 18 rekomandime, (11 të lëna në vitin 2017 dhe 7 të pazbatuara), në fakt janë 14 rekomandime, për t'u audituar për zbatimin e tyre.

Gjetje: Nga 14 rekomandimet e lëna në auditimin e fundit të kryer për periudhën deri më 31.12.2017, përfshirë edhe rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme e të pazbatuara, struktura menaxhuese e SHÇBA, ka realizuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht ose në proces realizimi 5 rekomandime dhe nuk janë realizuar 4 rekomandime. Gjithashtu nga insitucioni, nuk është caktuar një punonjës për komunikuar, monitoruar dhe informuar, për progresin e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me pikën 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” të MAB.

Moszbatimi i rekomandimeve, të gjitha të pranuar nga Institucioni, është në kundërshtim me nenin 9, pika 2 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi titullarët e institucionit sipas periudhave si dhe personat e ngarkuar në planin e veprimit për zbatimin e tyre.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Në projekt raportin e auditimit tuaj të realizuar për periudhën Janar-Dhjetor 2017, keni lënë 12 rekomandime” dhe shpreheni që ka rekomandime të dubluara.

“Përsa i përket rekomandimit nr.10 “Menaxhimi i lartë i organizatës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Përafrimit të Legjislacionit në MPB, të iniciojnë përgatitjen e një udhëzimi për interpretimin e VKM për trajtimin e punonjësve me pagë kalimtare. Ky Udhëzim të jetë unifikues për të gjithë programet e MPB”, drejtoria jonë ka dërguar shkresën nr.601, datë 26.03.2020 “Kërkesë për interpretim” pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (bashkëngjitur shkresa përcjellëse). Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. 1898/1 prot datë 07.04.2020, ka argumentuar pagesën kalimtare të punonjësve të SHÇBA, të cilën po e dërgojmë bashkëlidhur. Nga ana jonë do të fillojë menjëherë trajtimi me pagesë kalimtare në përputhje me interpretimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Për dublimin e rekomandimeve të lëna në fund të auditimit të kryer në vitin 2017 me rekomandimet e pazbatuara, observimi Juaj qëndron. Për këtë arsye, grupi i auditëve, ka përcaktuar se cilat janë rekomandimet e dubluara dhe nga 18 rekomandime, (11 rekomandime të lëna në vitin 2017 dhe 7 rekomandime të mbartura të pazbatuara, janë audituar e trajtuar 14 rekomandime. Kjo është trajtuar në faqen 10 të këtij materiali.

Për një rekomandim të lënë në projekt raport, për tatimin në burim që ishte përcaktuar me statusin “I pazbatuar”, është ndryshuar dhe është përcaktuar me statusin “Në proces zbatimi”, pasi me shkresën Tuaj nr.429 datë 03.03.2020, i jeni drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në MFE për dhënie mendimi.

Për rekomandimin e lënë për trajtimin e punonjësve me pagë kalimtare, Ju keni kërkuar zyrtarisht dhe keni marrë interpretim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), (shkresa e tyre 1898/1, datë 07.04.2020). Sipas interpretimit të bërë nga ISSH, paga kalimtare është ashtu siç jemi shprehur në projekt raportin e auditimit.

Nga sa sqaruar më lart, në krahasim me projekt raportin, në raportin final ndryshon vetëm statusi i një rekomandimi, nga “I pazbatuar”, kalon me statusin “Në proces zbatimi”.

Sa sipër vlerësojmë se, bazuar në analizimin e zbatimit të rekomandimeve institucioni është përpjekur për vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve, por zbatimi i tyre është në një nivel të ulët. Zbatimi i tyre, në disa fusha, nuk ka ndikuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të organizatës, kjo referuar edhe vlerësimin të dokumentacionit e procedurave të ndjekura gjatë periudhës së audituar. Pra mbetet ende detyrë që menaxhimi të marrë masat e duhura, duke bërë të gjitha përpjekjet për realizimin e plotë të të gjitha rekomandimeve, sidomos rekomandimeve të trashëguara e të pa zbatuara.

2. Auditimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, në funksion të përmbushjes së objektivave të Institucionit dhe përgjegjësi që rrjedhin nga ligji nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” dhe akteve të tjera ligjore, nënligjore e normative që rregullojnë objektin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Nisur nga objektivi primar i përcaktuar në planin vjetor dhe programet e punës së këtij institucioni, që është vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe funksionimi i tyre, auditimi është përqëndruar kryesisht në metodat, procedurat dhe proceset e punës sipas ndarjes strukturore, për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe raportimin e informacioneve financiare ose jo financiare. Njësia publike SHÇBA, për periudhën e audituar, nuk rezulton të ketë ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar e kontrollit, në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, konkretisht :

Mjedisi i kontrollit. U auditua mjedisi i kontrollit në njësinë publike SHÇBA dhe rezultoi se punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e punës në bazë të VKM nr.829, datë

03.12.2014 “Për miratimin e Rregullores së SHÇBA në MPB”, të ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil dhe të Kodit të Punës, sipas strukturave (punonjës me gradë, punonjës me status nëpunësi civil dhe punonjës të shërbimeve mbështetëse).

Rregullorja e institucionit, ka procedura të shkruara sipas organizimit strukturor të SHÇBA dhe rregullon veprimtarinë e kësaj organizate, referuar akteve ligjore, nënligjore e normative. Por për periudhën e audituar (nga 01.01.2018 deri më 31.12.2019), institucioni i SHÇBA, ka patur ndryshime në organikë dhe në strukturë. Në vitin 2017, në organikë ka një zëvendës drejtor të përgjithshëm, kurse në zbatim të urdhrit të MB nr.579 datë 26.10.2018, “Për miratimin e strukturës dhe përbërjes organike të SHÇBA”, është me dy zëvendës drejtorë të përgjithshëm. Sektorët e SHÇBA, nga 11 sektorë që kanë qënë në vitin 2017, janë bërë 6 drejtori në vitin 2018, (pra ka ndryshuar edhe emërtimi i sektorëve dhe janë bërë drejtori, por ka ndryshuar edhe numri i tyre). Gjithashtu në rregulloren e brendshme egzistuese, neni 4 i saj, është përcaktuar që stema e institucionit është MPB, kur në fakt është MB, (është ndryshuar vula e institucionit dhe nuk është bërë ndryshimi në rregulloren e brendshme).

Përmirësimi i rregullores së brendshme dhe përshtatja e saj me të gjitha ndryshimet ligjore e strukturore, kërkohet për shkak se në përputhje me rregulloren e brendshme, përgatiten planet e punës me informacion mbi objektivat operacionale të cilat janë planifikuar për t'u arritur. Në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike për të gjitha strukturat, (në rastin konkret të strukturave të SHÇBA). Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor, shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike, kjo për faktin se në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Nga ana e institucionit të SHÇBA, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GSM), megjithëse në auditimin e fundit të kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MB, është lënë rekomandim të krijohet kjo strukturë. Akoma nuk është miratuar me urdhër të brendshëm të titullarit të njësisë publike, ngritja e grupit të menaxhimit strategjik, si dhe nuk ka të përcaktuar kordinatorin e riskut të institucionit (personin përgjegjës) për bashkrendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve si dhe për raportimin e përgjithshëm të risqeve të institucionit te titullari i institucionit. Këto veprime janë kundërshtim me nenet 10, 11 dhe 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, përgjegjësi e strukturës menaxhuese të njësisë publike. Duke qënë se njësia publike nuk e ka krijuar GSM, nuk është krijuar regjistri i riskut i cili duhet të përmbajë objektivin e riskut sipas zyrave, sektorëve e drejtorive, riskun e identifikuar, kontrolllet ekzistuese, vlerësimin e riskut pas kontrollit, nevoja për kontrole të munguara, adresimi i boshllëqeve, zotëruesi i riskut etj, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e aneksit 2 të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit, Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nr.16, datë 20.07.2016, përgjegjësi e strukturës menaxhuese të institucionit.

Në fillim të çdo viti, në zbatim të rregullores së brendshme të institucionit, neni 23 “Përgjegjësitë për hartimin dhe miratimin e strategjive, programeve dhe planeve” është hartuar programi mbi veprimtarinë e njësisë publike SHÇBA për vitin në vazhdim duke evidentuar drejtimet, masat e planizuara, afati, struktura përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëvepruese. Në programin vjetor është parashikuar: baza ligjore, vlerësimi i situatës ekzistuese; objektivi kryesor; synime për arritjen e objektivit dhe detyrat kryesore për kuadrin ligjor, për

modernizimin e sistemit të komunikimit, për gadishmërinë dhe detyrat konkrete sipas strukturave. Në përfundim të vitit kalenderik (vitit buxhetor), është kryer analiza vjetore e veprimtarisë së njësive publike SHÇBA dhe realizimit të detyrave.

- *Menaxhimi i riskut.* Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësive”, pika 2 e këtij neni, nuk ishte kryer identifikimi dhe krijimi i regjistrit të riskut në vitet 2018 dhe 2019, nuk është kryer vlerësimi, kontrolli i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që drejtojnë.

Regjistri i riskut ishte hartuar vetëm nga sektori i financës, regjistër në të cilin kishte të identifikuar risqet për objektivat e sektorit të financës, por meqënëse nuk ka regjistër përmbledhës të njësive publike, nuk janë të identifikuar risqet e kontrollit, të sektorit të logjistikës, të burimeve burimeve njerëzore (ku përfshihen edhe strukturat mbështetëse e SHÇBA), dhe drejtorive, sektorëve dhe zyrave të tjera të njësive publike.

Procesi i menaxhimit të riskut, zhvillimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, (MFK), kërkon zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Risqet janë të pashmangshme në operacionet e përditshme. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësive, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arësyeshme se objektivat do të arrihen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion (njerëzore e financiare), që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Për një identifikimi sa më real të risqeve, mirëpërcaktim i objektivave që ka çdo strukturë vepruese dhe operuese e kësaj njësie publike, hartës së proceseve të punës dhe gjurmës së auditimit referuar Manualit të MFK, do të ndihmonin këtë institucion në funksionimin më të mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm.

- *Aktiviteti i Kontrollit:* Veprimtaritë e kontrollit kanë të bëjë me procedurat dhe politikat e shkruara e të miratuara nga menaxhimi, për të dhënë siguri të arësyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Nga auditimi rezultoi se është ngritur dhe në përgjithësi funksionon një sistem kontrolli i brendshëm, kjo nëpërmjet gjurmës së auditimit si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësive, apo ndërmjet vetë njësive dhe institucioneve të jashtme. Kjo duket në planifikimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm, përdorimin e tij mbi bazën e një dokumentacioni justifikues, kontabilizimi i veprimeve sipas standarteve kontabël, plotësimi i organikës me funksionet kryesore e menaxhuese, mbajtja e dosjeve të personelit, mbajtja e sistemit të dokumentacionit të bankës e të arkës, etj.

Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces. Megjithatë, gjetjet e konstatuara nga kryerja e auditimit në sistemet e programuara për auditim, tregojnë

se aktiviteti i kontrollit të brendshëm, nuk kryhet në vazhdimësi dhe nuk është i plotë në të gjitha hallkat menaxhuese të kësaj njësie publike.

- *Informimi dhe Komunikimi.* Menaxherët e njësisë publike zotërojnë informacion lidhur me përmbushjen e detyrave dhe marrjen e përgjegjësi për MFK, por mungon ngritja dhe zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e lartë të njësisë publike, që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë e të saktë, për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në MFK. Titullari, (nëpunësi autorizues) informohet nga drejtuesit e zyrave, sektorëve e drejtorive të njësisë, nëpërmjet takimeve, mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme që i vihen në dispozicion.

- *Monitorimi:* Ky komponent i funksionimit të sistemit të MFK, cili përbën një proces të rëndësishëm nëpërmjet të cilit titullari i njësisë publike, realizon rishikimin e gjithë aktivitetit të institucionit, për sigurimin e garancive të njohjes së faktorëve që bëhen pengesë në plotësimin e detyrës.

Auditimi i këtij Institucioni kryhet nga DAB në MB. Nëpërmjet raporteve të auditimit, titullari informohet për problemet dhe mbi këtë bazë përcakton rrugët e zgjidhjes. Por nga auditimi i kryer, rezultoi se zbatimi i rekomandimeve është në një nivel të ulët. Moszbatimi i rekomandimeve, nuk e ka ndihmuar menaxhimin në përmirësimin e situatës dhe në realizimin e objektivave të kësaj njësie publike.

Gjetje: Njësia publike SHÇBA, në kuadrin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me gjithë përmirësimet e bëra nuk ka arritur që :

- Të krijojë një mjedis të plotë kontrolli, që nga viti 2014 e në vazhdim, ka patur ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të strukturës dhe organikës së institucionit, por edhe ndryshime ligjore dhe këto ndryshime nuk janë reflektuar në rregulloren e brendshme të veprimtarisë së këtij institucioni.

- Nuk është miratuar me urdhër të brendshëm të titullarit të njësisë publike, ngritja GSM, si dhe nuk ka të përcaktuar kordinatorin e riskut të njësisë publike (personin përgjegjës) për bashkrendimin e veprimtarive të drejtorive, sektorëve e zyrave, që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve si dhe për raportimin e përgjithshëm të risqeve të institucionit të titullari i institucionit.

- Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të pasqyrohen objektiva të qarta lidhur me misionin që ka ky institucion, vlerësimi dhe kontrolli i risqeve në arritjen e objektivave. Ky regjistër është hartuar vetëm nga sektori i financës. Nga ana e strukturave operacionale dhe strukturave të tjera të institucionit, nuk është implementuar akoma Manuali i MFK.

- Institucioni nuk ka arritur të kryejë aktivitetin e kontrollit të brendshëm në vazhdimësi dhe në mënyrë të plotë, në të gjitha hallkat menaxhuese, kjo pasqyrohet te moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna dhe i gjetjeve të konstatuara gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit. Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenet 9,10, 11 dhe 18, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi strukturat menaxhuese të njësisë publike dhe nëpunësin autorizues.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “..... bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (MFK) i azhornuar me ligjin nr.110/2015, neni 8 pika 8, theksohet titullarët e njësive publike në fushën e MFK kanë këto kompetenca kryesore ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik (GSM) të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji.Në nenin 27, pika 2, theksohet: GSM përbëhet nga titullari i njësisë publike, zv/titullarët, nëpunësit autorizues e zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerëtë nivelit të lartë. Kreu i

auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e GSM pa të drejtë vendimmarrjeje. Në këtë kuptim ngritja e GSM, është kompetencë e Institucioneve qendrore (Ministrit). Ne si njësi buxhetore hartojmë regjistër rrisht, i cili është hartuar por jo GSM”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 8, kompetencat e titullarit, pika 8/b përcakton që titullari ka për detyrë, “Ngritjen e GSM të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji”. Gjithashtu në zbatim të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar nenit 4, pika 8, përcaktohet që “Të gjitha nivelet e njësisë publike” është termi që i referohet njësive të përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe nënkupton organin qendror të njësisë publike dhe secilën njësi vartëse të konsideruar më vete”. Njësia shpenzuese SHÇBA, është njësi publike me vete, (me buxhet, me bilanc dhe me drejtim me vete, pavarësisht varësisë nga organi qendror MB), pra kjo njësi në kuptimin e ligjit për MFK, duhet të ngrejë GSM.

Nisur nga sqarimet e bëra më sipër, observimi i bërë nga Ju për këtë gjetje, nuk merret në konsideratë dhe nuk reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

Sa sipër vlerësojmë së, nga auditimi lidhur me funksionimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me gjithë arritjet, ka nevojë për përmirësime në drejtim të plotësisë të elementëve të mjedisit kontrollit, ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, përpilimin e regjistrit të rrishtit dhe vlerësimin e menaxhimit më mirë të rrishtit, në shtrirjen e sistemit të kontrollit në të gjitha hallkat menaxhuese të njësisë publike, etj.

3. Auditimi i sistemit të buxhetit.

-Përgatitja e buxheteve vjetore për vitet 2018 dhe 2019, argumentimi i limiteve të kërkuara.

Në auditimin për procedurat e hartimit të buxhetit për periudhën e audituar u konstatua se projekt buxheti i vitit 2018, është hartuar sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të zbatimit të buxhetit të shtetit. Janë zbatuar afatet e përcaktuara për përgatitjen dhe raportimin e projekt buxheteve vjetore dhe afatmesme. Për periudhën e audituar (01.01.2018 deri më 31.12.2019), përgatitja e buxheteve është si më poshtë:

Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018 - 2020, është ngritur grupi i punës i përbërë nga pesë nëpunës, sipas urdhrit të titullarit nr.565 datë 05.04.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020”. Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të drejtorive, sektorëve dhe zyrave, por për planifikimin e buxhetit vjetor, kryesisht është marrë si bazë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor para ardhës. Mbi bazën e dokumentacionit të grumbulluar, nëpunësi zbatues i institucionit (Shefi i Sektorit të Financës), ka plotësuar të gjitha pasqyrat shoqëruese “Tip” të projekt buxhetit për programin që menaxhohen nga njësia shpenzuese SHÇBA. Këto pasqyra financiare, së bashku me relacionet sqaruese për zërat e shpenzimeve, janë konfirmuar nga drejtuesi i njësisë shpenzuese, (nëpunësi autorizues) dhe janë dërguar drejtorisë së përgjithshme ekonomike dhe të shërbimeve mbështetëse (drejtorisë së financave) në MB, me shkresën nr.1205 datë 01.08.2017.

Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019 - 2021, është ngritur grupi i punës i përbërë nga gjashtë nëpunës, sipas urdhrit të titullarit nr.785 datë 20.04.2018, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021”. Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat dhe realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor para ardhës. Nga nëpunësi zbatues i institucionit janë plotësuar të gjitha pasqyrat shoqëruese “Tip” të projekt buxhetit për programin që menaxhohen nga SHÇBA. Këto pasqyra financiare, së bashku me relacionet sqaruese për zërat e shpenzimeve, janë konfirmuar nga drejtuesi i njësisë shpenzuese, (nëpunësi autorizues) dhe janë dërguar pranë

drejtorisë së përgjithshme ekonomike dhe të shërbimeve mbështetëse (drejtorisë së financave) në MB, me shkresën nr.1275/1 datë 24.08.2018.

Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2018, është dërguar me shkresën e MB nr.9509 datë 18.12.2017. Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga institucioni qendror MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2018 dhe një kopje është dërguar MB, me shkresën nr.1936/1 datë 20.12.2017.

Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2019, është dërguar me shkresën e MB nr.9904 datë 24.12.2018. Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2019, dhe një kopje është dërguar MB, me shkresën nr.2126/2 datë 28.12.2018.

Nga auditimi i kryer në drejtim të ndryshimeve që kanë pësuar zërat e buxhetit gjatë viteve, rezulton se këto ndryshime (shtesa dhe pakësime), janë të regjistruara e të rakorduara me degën e thesarit të rrethit dhe janë të raportuara periodikisht në institucionin qendror. Për çdo ndryshim të zërave të buxhetit, në shtesë apo në pakësim, bashkëlidhur janë shkresat e institucionit qëndror, për ndryshimin e buxhetit. Detajimi i buxhetit, është bërë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 *”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”* si dhe Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 *“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”*.

Për miratimin e përdorimit të fondit të veçantë, nga ana e njësisë shpenzuese SHÇBA, janë bërë kërkesat për miratimin e përdorimit të fondit. Kërkesat e institucionit, pasi janë shqyrtuar dhe miratuar nga MFE, janë dërguar për veprim në institucion nëpërmjet MB. Detajimi i buxhetit, është bërë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 *”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”* si dhe Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 *“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”*.

Situacionet e shpenzimeve mujore dhe progresive që ka bërë institucioni, janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga dega e thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe ndryshimet e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit.

Analiza e realizimit të buxhetit është bërë mbi bazën e urdhër shpenzimeve të plotësuara, miratuara, kontrolluara, likuiduara dhe të regjistruara në librat e llogarisë, konform klasifikimit buxhetor. *(Ditari shpenzimeve)*. Konfirmimi i urdhërpagesave është bërë nga nëpunësi zbatues, në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Zbatimi i buxhetit.

Për vitin 2018, njësisë shpenzuese SHÇBA, i janë akordur fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë në shumën 240,400,000 lekë, vlera të cilat janë detajuar e miratuar si më poshtë :

1. Shpenzimet vjetore të planifikuara në artikullin 600 *“Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli”*, janë në masën 127,500,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor

2018, janë bërë pakësime në shumën 10,400,000 lekë dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 117,100,000 lekë.

2. Në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, planifikimi fillestar i fondit është në shumën 20,900,000 lekë. Për këtë artikull, për periudhën e vitit 2018, nuk ka shtesa ose pakësime, pra plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 20,900,000 lekë.

3. Për artikullin e shpenzimeve 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, është akorduar fondi vjetor për vitin 2018 në masën 26,000,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2018, nuk ka shtesa ose pakësime për këtë zë shpenzimesh.

4. Për shpenzimet e artikullit 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, është akorduar fondi fillestar për vitin 2018 në masën 3,000,000 lekë. Gjatë vitit buxhetor, janë bërë shtesa në shumën 216,700 lekë, palni me ndryshimet për vitin buxhetor 2018 është në shumën 3,216,700 lekë.

5. Për artikullin e shpenzimeve 231 “Shtesa të aktiveve të qëndrueshme”, akordimi fillestar i fondeve të planifikuara është në masën 63,000,000 lekë. Gjatë vitit 2018, janë pakësuar fonde në shumën 32,280,500 lekë dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në masën 30,619,500 lekë.

Nuk ka shtesa dhe pakësime të tjera të buxhetit fillestar për aktivitetin e njësisë shpenzuese SHÇBA për vitin buxhetor 2018. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në masën 96% ose në vlerën 189,785,586 lekë nga 197,836,200 lekë që është plani vjetor i ndryshuar :

Realizimi i buxhetit për vitin 2018, për SHÇBA, është si më poshtë :

Në lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Plani ndrysh	Fakti	Diferenca	Përqindja
1	600 “Paga shpenz personeli”	117,100,000	117,051,977	48,023	100
2	601 “Sigurime Shoqërore”	20,900,000	19,300,260	1,599,740	92
3	602 “Shpenzime operative”	26,000,000	20,597,593	5,402,407	79
4	606 “Trasferta te buxh.famil”	3,216,700	2,526,204	690,496	78.5
5	231 Shtesa e AQ	30,619,500	30,309,552	309,948	99
	TOTALI:	197,836,200	189,785,586	8,050,614	96

Siç shihet nga tabela e mësipërme, rezulton se nuk ka tejkalime të zërave të shpenzimeve të planifikuara. Në total, realizimi i shpenzimeve të planifikuara për vitin 2018, është në masën 96%.

Nga analiza e realizimit të buxhetit të planifikuar, rezulton se në zërin e shpenzimeve 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, realizimi është në masën 79%. Kjo tregon se institucioni ka bërë planifikim më shumë se nevojat për këtë zë shpenzimesh. Për vitin buxhetor 2019, planifikimi është në shumën 22 milion lekë, afërsisht sa shpenzimet faktike të vitit 2018.

Për vitin 2019, insitucionit të SHÇBA i janë akordur fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë në shumën 188,400,000 lekë, vlera të cilat janë detajuar e miratuar si më poshtë :

1. Shpenzimet vjetore të planifikuara në artikullin 600 “Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli”, për vitin 2019, janë në masën 127,500,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2019, janë bërë pakësime në shumën 4,000,000 lekë dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 123,500,000 lekë.

2. Në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, planifikimi fillestar i fondit është në shumën 20,900,000 lekë. Për këtë artikull, për periudhën e vitit 2019, nuk ka shtesa ose pakësime, pra plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 20,900,000 lekë.

3. Për artikullin e shpenzimeve 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, është akorduar fondi vjetor për vitin 2019 në masën 27,000,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2019, ka patur pakësime për shumën 4,150,000 lekë dhe plani i buxhetit i ndryshuar për këtë zë shpenzimesh, për vitin buxhetor 2019 është 22,850,000 lekë.

4. Për shpenzimet e artikullit 606 “Transferata për buxhetet familjare dhe individët”, është akorduar fondi fillestar për vitin 2019 në masën 2,000,000 lekë. Gjatë vitit buxhetor, janë bërë shtesa në shumën 5,037,337 lekë, palni me ndryshimet për vitin buxhetor 2019 është në shumën 7,037,337 lekë.

5. Për artikullin e shpenzimeve 231 “Shtesa të aktiveve të qëndrueshme”, akordimi fillestar i fondeve të planifikuara është në masën 11,000,000 lekë. Gjatë vitit 2019, nuk ka ndryshime të këtij zëri shpenzimesh, pra shuma e planifikuar për vitin 2019 është 11,000,000 lekë.

Nuk ka shtesa dhe pakësime të tjera të buxhetit fillestar për aktivitetin e njësisë shpenzuese SHÇBA për vitin buxhetor 2019. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në masën 97% ose në vlerën 179,874,571 lekë nga 185,287,337 lekë që është plani i ndryshuar :

Realizimi i buxhetit për vitin 2019, për SHÇBA, është si më poshtë :

Në lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Plani ndrysh	Fakti	Diferenca	Përqindja
1	600 “Paga shpenz. personeli”	123,500,000	120,690,805	2,809,195	97.7
2	601 “Sigurime Shoqërore”	20,900,000	19,999,237	900,763	95.7
3	602 “Shpenzime operative”	22,850,000	21,223,177	1,626,823	93
4	606 “Transferata buxh. famil”	7,037,337	6,969,760	67,577	99
5	231 Shtesa e AQ	11,000,000	10,991,592	8,048	100
	T O T A L :	185,287,337	179,874,571	5,412,766	97

Nuk ka shtesa dhe pakësime të tjera të buxhetit fillestar për aktivitetin e njësisë shpenzuese SHÇBA për vitin buxhetor 2019. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në masën 97% ose në vlerën 179,874,571 lekë nga 185,287,337 lekë që është plani i ndryshuar :

Siç shihet nga tabela e mësipërme, rezulton se nuk ka tejkalime të zërave të shpenzimeve të planifikuara. Në total, realizimi i shpenzimeve të planifikuara për vitin 2019, është në masën 96% (nga 185,287,337 lekë sipas planit me ndryshime, realizimi është 179,874,571 lekë).

Nga analiza e realizimit të buxhetit të planifikuar, rezulton se në zërin e shpenzimeve 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, realizimi është në masën 93%. Kjo tregon se institucioni ka bërë planifikim me rezerva të këtyre dy zërave të shpenzimeve, pasi për këtë zë shpenzimesh, për vitin buxhetor 2019 ka patur pakësime të konsiderueshme.

Sa sipër vlerësojmë se, në përfundim të auditimit të sistemit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit për funksionimin e veprimtarisë së institucionit Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, menaxhimi dhe stafi i institucionit, ka zbatuar aktet ligjore e nënligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit. Më mirë duhej të ishte punuar në drejtim të realizimit të buxhetit për vitet 2018 dhe 2019, në veçanti për zërin e shpenzimeve 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”.

4. Auditimi i procedurave ligjore për prokurimin e fondeve, realizimi i kontratave.

- *Parashikimi i prokurimeve në regjistrin e prokurimeve dhe vlerësimi mbi zgjedhjen e procedurave të prokurimit sipas fondit limit. Auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore për dokumentimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit. Auditimi mbi zbatimin e kërkesave*

ligjore për lidhjen e kontratave, dokumentimi e zbatimi i tyre. Auditimi për zbatimin e kontratave mbi marrjet në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve. Auditimi për rregullshmërinë e likuidimit të kontratave, kontrolli i dokumentave mbështetëse justifikuese dhe fatuarve të paraqitura në financë për likuidim.

Gjetje: Për periudhën e përfshirë në auditim (vitet 2018 e 2019), nuk ka dalë urdhri i Autoritetit Kontraktor për përcaktimin në fillim të vitit të personit përgjegjës, për prokurimet publike dhe dërgimin e emrit pranë APP. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 57, të VKM nr.914, datë 29.12.2017, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar, pika 1 e të cilit përcakton që “AK, në fillim të vitit cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në APP”, veprim për të cilin kanë përgjegjësi titullarët e AK sipas periudhave.

Për vitin 2020, ka dalë urdhri i titullarit të AK nr.187, datë 03.02.2020 “Për caktimin e personit përgjegjës për prokurimet publike” dhe me shkresë nr.187/1, datë 03.02.2020 të AK është njoftuar APP.

Për prokurimet e vitit 2018,

Sipas planit të buxhetit për artikujt 602 “Mallra e shërbime” dhe 231 “Shpenzime për rritjen e AQ” të njësisë shpenzuese SHÇBA, në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve, i cili është dërguar me shkresën nr.10, datë 04.01.2018 “Dërgohet regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike”, në institucionin qendror MB.

Për vitin 2018, nga stukturat përgjegjëse të njësisë shpenzuese SHÇBA, u paraqit regjistri i parashikimit të prokurimeve në fillim të vitit dhe ndryshimet e bëra deri në muajin Qershor të këtij viti. Këto të dhëna janë dërguar me shkresë të AK në MB (manualisht). Në fund të vitit na u paraqit regjistri i parashikimit dhe realizimit i printuar nga sistemi.

- Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve i printuar nga sistemi janë parashikuar për t’u zhvilluar 11 procedura prokurimi në vlerën 31,740,668 lekë (pa tvsh) si më poshtë:

I. Nëntë procedura prokurimi blerje me vlera të vogla me vlerë 2,574,001 lekë (pa tvsh).

II. Dy procedura prokurimi publik të përqëndruara për tu zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në MB në vlerën 29,166,667 lekë (pa tvsh), dhe konkretisht:

1. “Blerje bojra, tonera”, fondi limit nga 602, me vlerë 1,666,667 lekë (pa tvsh).
2. “Blerje automjetesh”, fondi limit nga 231, me vlerë 27,500,000 lekë (pa tvsh).

I.Realizimi i procedurave me blerje me vlera të vogla,

Gjatë vitit 2018, janë prokuruar (zhvilluar) tetë procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në vlerën 2,061,140 lekë (pa tvsh) nga nëntë të parashikuara në vlerë 2,574,001 lekë (pa tvsh) dhe konkretisht:

1. Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit (blerje bileta avioni), janë shpenzuar 597,250 lekë nga 760,000 lekë e parashikuar. Me urdhër të titullarit nr.416, datë 23.02.2018, është ngritur komisioni për sistemin dinamik të biletave i përbërë nga tre anëtarë. Gjatë vitit janë zhvilluar pesë procedura me blerje vlera të vogla dhe likuidimi është kryer me urdhërshpenzimi bashkëlidhur dokumentacioni. Procedura e blerjeve me vlera të vogla të biletave për jashtë shtetit është kryer në zbatim të akteve ligjore për prokurimin publik, për çdo procedurë është lidhur kontrata me OE fitues.

2. Blerje “Kancelari”, janë shpenzuar 321,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 416,667 lekë (pa tvsh), i parashikuar në regjistrin e parashikimit. Vlera e blerjes është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.55, datë 26.03.2018 në vlerë 385,200 lekë.

3. Blerje 'Letër', janë shpenzuar 65,900 lekë (pa tvsh), fondi limit 95,667 lekë (pa tvsh) i parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.61, datë 30.03.2018 në vlerë 79,080 lekë (me tvsh).

4. Blerje "Materiale pastrimi", janë shpenzuar 87,983 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 166,667 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit. Mallrat e blera janë likuiduar me urdhërshpenzimi nr.59, datë 30.03.2018 në vlerë 105,580 lekë.

5. "Materiale shërbimi specifike", janë shpenzuar 8,333 lekë (pa tvsh) nga 10,000 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit. Është likuiduar vlera me urdhërshpenzimi nr.60, datë 30.03.2018 shuma 10,000 lekë.

6. "Shpenzime prodhim dokumentash", janë shpenzuar 98,500 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 100,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.

Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.160, datë 03.08.2018 në vlerë 118,200 lekë.

7. Shërbime të printimit dhe publikimit, vlera 68,625 lekë (pa tvsh) nga 125,000 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit. Ky shërbim është kryer nga gazeta Shqiptarja.com.

8. "Blerje printera dhe Fotokopje", janë shpenzuar 755,550 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 800,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit me ndryshime. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.270, datë 21.12.2018 në vlerë 906,660 lekë.

Për blerjet me vlera të vogla, nuk është realizuar një procedurë nën vlerën 100,000 lekë me objekt "Shpenzime për prodhim dokumentacioni sekret".

Nga auditi i procedurave me blerje me vlera të vogla të ndjekura rezultoi se këto praktika blerje janë realizuar konformë bazës ligjore për prokurimet, nuk u evidentua copëtim fondi për shërbime e mallra të njëjta përgjatë një periudhe buxhetore.

II. Nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në MB janë zhvilluar dy procedura prokurimi publik të përqëndruara të parashikuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2018, por që nuk janë relatuar në regjistrin e realizimit të prokurimeve dhe konkretisht:

1. Blerje bojra, tonera, me vlerë 1,641,848 lekë (pa tvsh) nga vlera 1,666,667 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.

Është lidhur kontrata nr.1659, datë 16.10.2018 "Blerje tonera", kohëzgjatja 30 ditë nga lidhja e kontratës. Kontrata është lidhur midis "Infosoft Office shpk" dhe SHÇBA përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MB me shkresë nr.20/10, datë 29.08.2018. Likuidimet për zbatimin e kontratës janë bërë me USH nr.273, datë 24.12.2018, vlera 1,970,218 lekë (me tvsh). Bashkëlidhur është dokumentacioni i plotë justifikues, faturë tatimore nr.228957536, datë 27.11.2018, fletëhyrje nr.54, datë 03.12.2018, procesverbali datë 03.12.2018 i marrjes në dorëzim në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni në të cilën shprehen se mallrat e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike.

2. "Blerje automjete", nga fondet re planifikuara për rritjen e AQ për investime janë shpenzuar 24,478,650 lekë (pa tvsh) nga 27,500,000 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve.

- Është lidhur kontrata nr.921/1, datë 02.07.2018 për blerjen e tre mjeteve fuoristradë me vlerë 7,663,500 lekë (me tvsh) midis OE "Albania Motor Compani" përfaqësuar nga Gentian Karaj dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA, i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MB me shkresë nr.5/10, datë 22.05.2018. Afati lëvrimit 60 ditë nga lidhja kontratës. Likuidimet për zbatimin e kontratës janë bërë me USH nr.163, datë 10.08.2018 me vlerë 2,554,500 lekë, (faturë tatimore nr.326, datë 30.07.2018, fletë hyrje nr.25, datë 03.08.2018), USH nr.164, datë 10.08.2018 me vlerë 2,554,500 lekë, (faturë tatimore nr.327, datë 30.07.2018, fletë hyrje nr.26, datë 03.08.2018) dhe USH nr.165, datë 10.08.2018 me vlerë 2,554,500 lekë, (faturë tatimore 328, datë 30.07.2018, fletë hyrje 27, datë 03.08.2018). Proces verbalet e marrjes në dorëzim të mjeteve me nr.1, 2 dhe 3 më datë 03.08.2018, janë mbajtur

në zbatim të urdhrimit të DP nr.1206, datë 30.07.2018 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorzim të mjeteve”.

- Është lidhur kontrata nr.1100/1, datë 22.08.2018 për blerjen e 11 mjeteve Hyundai me vlerë 19,316,880 lekë (me tvsh) midis OE ”Hyundai Auto Albania shpk” përfaqësuar nga Ilir Zeka dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA, i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MB me shkresë nr.5/16, datë 04.07.2018. Afati lëvrimit 60 ditë nga lidhja kontratës. Likuidimet për zbatimin e kontratës janë bërë me USH nr.216, datë 06.11.2018 me vlerë 1,782,000 lekë, (faturë tatimore nr.551, datë 11.09.2018, fletë hyrje nr.33, datë 22.10.2018), USH nr.222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, datë 19.11.2018 me vlerë 1,753,488 lekë secili USH, (faturë tatimore nr.762, 763, 764, 664, 667, 668, 669, 670, 671, 819, datë 25.10.2018, fletë hyrje nr.34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, datë 26.10.2018). Proces verbalet e marrjes në dorzim të 10 mjeteve më datë 26.10.2018 janë mbajtur në zbatim të urdhrimit të DP nr.1696, datë 22.10.2018 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorzim të mjeteve”.

- Është lidhur kontrata nr.1687/1, datë 18.10.2018 për blerjen e një mjeti me vlerë 2,394,000 lekë (me tvsh) midis OE ”Posche Albania shpk” dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA, i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MB me shkresë nr.28/38, datë 18.10.2018. Afati lëvrimit 60 ditë nga lidhja kontratës. Likuidimet për zbatimin e kontratës janë bërë me USH nr.252, datë 11.12.2018 me vlerë 2,394,000 lekë, (faturë tatimore nr.2786, datë 19.11.2018, fletë hyrje nr.45, datë 27.11.2018). Proces verbali i marrjes në dorzim të mjetit, është mbajtur më datë 27.11.2018 në zbatim të urdhrimit të DP nr.1916, datë 27.11.2018 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorzim të mjeteve”.

Gjetje: Për vitin 2018, në regjistrin e realizimit të prokurimeve, i printuar nga sistemi elektronik i APP, nuk janë hedhur dy procedurat e prokurimi publik, blerje bojra, tonera me vlerë 1,666,667 lekë (pa tvsh) dhe blerje automjete me vlerë 27,500,000 lekë (pa tvsh) të parashikuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve, të realizuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në MB. Ky veprim është në *kundërshtim me udhëzimin nr.1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit publik dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, përgjegjësi e titullarit të AK dhe personit përgjegjës për sistemin për vitin 2018.*

Për vitin buxhetor 2019.

Sipas planit të buxhetit ta akorduar njësisë shpenzuese SHÇBA për vitin 2019, janë akorduar për artikullin 602 “Shpenzime operative” dhe 231 “Shpenzime për rritjen e AQ”, në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve publike, i cili është dërguar në institucionin qëndror MB me shkresën prot. nr.143, datë 28.01.2019 “Dërgohet regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike”.

Nga strukturat përgjegjëse (drejtoria e shërbimeve mbështetëse), grupit të auditit ju paraqit regjistri i parashikimit të prokurimeve në fillim të vitit, ndryshimet të cilat janë dërguar me shkresë të AK në MB (manualisht), regjistri i realizimit i cili ishte raportuar periodikisht për çdo 4 muaj dhe në fund të vitit 2019 është dërguar me shkresën prot. nr.14, datë 07.01.2020 pranë njësisë përgjegjëse në MB dhe në ABP.

Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve janë parashikuar për t’u zhvilluar 18 procedura prokurimi në vlerën 15,547,279 lekë (pa tvsh) si më poshtë:

- I.** Procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në 16 raste me vlerë 2,547,279 lekë (pa tvsh).
- II.** Një procedura prokurimi publik të përqëndruara për tu zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në MB me vlerë 1,500,000 lekë (pa tvsh), “Blerje bojra, tonera”.
- III.** Një procedurë prokurimi pa shpallje (sekrete) me vlerë 11,500,000 lekë (pa tvsh).

I.Realizimi i procedurave me blerje me vlera të vogla,

Gjatë vitit 2019, janë prokuruar (zhvilluar) 16 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në vlerën 1,957,648 lekë (pa tvsh) dhe konkretisht:

1.Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit, me vlerë totale 74,156 lekë (blerje bileta avioni) nga 250,000 lekë e parashikuar në regjistrin e parashikimit.Me urdhrin nr.29/1, datë 14.02.2019 të titullarit, është ngritur komisioni për sistemin dinamik të biletave i përbërë nga tre anëtarë. Gjatë vitit janë zhvilluar dy procedura me blerje vlera të vogla.

2.Blerje “Kancelari”, janë shpenzuar 289,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 416,667 lekë parashikuar në regjistrin e parashikimit në fillim të vitit 2019.

Vlera është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.64, datë 05.04.2019 në vlerë 153,600 lekë dhe nr.169, datë 07.08.2019 në vlerë 193,200 lekë.

3. Blerje “Materiale pastrimi”, janë shpenzuar 78,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 166,667 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.Është likuiduar vlera me urdhërshpenzimi nr.63, datë 05.04.2019 në shumën 93,600 lekë.

4. “Blerje dokumentacioni specifik” (dosje), janë shpenzuar 165,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 166,667 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.229, datë 25.10.2019 në vlerë 198,000 lekë.

5. Shpenzime “Materiale zyre”, janë shpenzuar 41,666 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 41,666 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.223, datë 17.10.2019 në vlerë 50,000 lekë.

6. “Shërbime”(ndërtimi faqes së vvebsite materiale promovuese), janë shpenzuar 126,388 lekë (pa tvsh) nga 180,000 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit.Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.189, datë 11.09.2019 në vlerë 87,000 lekë dhe me nr.175, datë 27.08.2019 në vlerë 64,666 lekë.

7. Shërbime skanimi, instalim paisjeve”, janë shpenzuar 96,800 lekë (pa tvsh) nga 96,800 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.234, datë 28.10.2019 në vlerë 116,160 lekë.

8. Blerje “Materiale kancelari”, janë shpenzuar 146,000 lekë (pa tvsh) nga 221,073 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e prokurimit me ndryshime gjatë vitit. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.270, datë 13.12.2019 në vlerë 175,200 lekë.

9. Blerje “Materiale pastrimi disifiktemi”, janë shpenzuar 89,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 129,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit me ndryshime. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.282, datë 24.12.2019 në vlerë 106,800 lekë.

10. “Blerje printera”, janë shpenzuar 84,200 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 84,350 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.266, datë 11.12.2019 në vlerë 101,040 lekë.

11. “Blerje shtypshkrime sekrete”, janë shpenzuar 515,000 lekë (pa tvsh) nga fondi limit 518,750 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.285, datë 31.12.2019 në vlerë 618,000 lekë.

12. “Instalim sistemi GPS”, janë shpenzuar 33,600 lekë (pa tvsh) nga 34,206 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.

13. “Instalim Programi Softe”, janë shpenzuar 100,000 lekë (pa tvsh) nga 100,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit. Kjo procedurë nuk është zhvilluar elektronikisht pasi vlera është nën 100,000 lekë.Shërbimi është bërë dalje me faturë tatimore nr.2772, datë 05.12.2019. Është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.265, datë 11.12.2019 në vlerë 120,000 lekë.

14. “Blerje ftesa dhe Bexha”, janë shpenzuar 34,600 lekë (pa tvsh) nga 45,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit. Kjo procedurë nuk është zhvilluar elektronikisht pasi

vlera është nën 100,000 lekë (pa tvsh).Vlera e mallit, është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.271, datë 13.12.2019 në vlerë 41,520 lekë.

15. Blerje baner, janë shpenzuar 13,038 lekë (pa tvsh) nga 13,100 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit. Kjo procedurë nuk është zhvilluar elektronikisht pasi vlera është nën 100,000 lekë (pa tvsh).Malli është likuiduar me urdhërshpenzimi nr.272, datë 13.12.2019 në vlerë 15,646 lekë.

16. Shërbime të printimit dhe Publikimit, janë shpenzuar 71,200 lekë (pa tvsh) nga 83,333 lekë (pa tvsh) e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike. Ky shërbim është kryer nga gazeta Shqiptarja.com.

II. Një procedurë prokurimi publik të përqëndruara të parashikuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2019, nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në MB dhe konkretisht:

1. Blerje bojra, tonera, nga artikulli i shpenzimeve 602, procedura "Tender i hapur", janë shpenzuar 1,489,543 lekë (pa tvsh) ose 1,787,452 lekë (me tvsh) nga 1,500,000 lekë (pa tvsh) parashikuar në regjistrin e parashikimit.

Është lidhur kontrata nr.1323/2, datë 108.07.2019 "Blerje tonera", midis OE Fitues "Infosoft Office shpk" dhe SHÇBA përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i autorizuar nga SP i MB me shkresë nr.14/39, datë 17.06.2019. Likuidimi për zbatimin e kontratës është bërë me USH nr.176, datë 27.08.2019, vlera 1,787,452lekë. Bashkëlidhur është dokumentacioni i plotë justifikues, procesverbali i marrjes në dorëzim në sasi dhe cilësi mbajtur më datë 07.08.2019 i nënshkruar nga komisioni në të cilën shprehen se mallrat e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike, faturë tatimore nr.32185880, datë 06.08.2019 dhe fletëhyrje nr.60, datë 07.08.2019.

III. Një procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake njoftim të kontratës (sekrete) në artikullin 231 me vlerë 9,075,460 lekë (pa tvsh) ose 10,890,552 lekë (me tvsh) nga 11,500,000 lekë (pa tvsh), parashikuar në regjistrin e parashikimit e zhvilluar jo në sistem elektronik.

Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizuar e të administruar në dosje të veçantë nga Zyra e Kartotekës së SHÇBA cila është një zyrë dokumentacioni e informacioni të klasifikuar "Sekret shtetëror" rezultoi se procedura e prokurimit nuk i nënshtrohet prokurimit publik, por është realizuar bazuar në VKM nr.701, datë 22.10.2014 "Për miratimin e rregullave për sigurimin e informacionit në fushën industrial" dhe Udhëzimin e MB nr.499, datë 01.10.2015 "Për zbatimin e VKM nr.701, datë 22.10.2014.

Është përcaktuar struktura brenda SHÇBA, që do të realizojë kryerjen e procedurës së prokurimit. Me urdhër të titullarit është caktuar personi përgjegjës, grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike. AK (Sekretari i Përgjithshëm) ka nxjerrë urdhrin e prokurimit të klasifikuar me fond limit 9,166,666 lekë (pa tvsh), llojin e procedurës "Me negociim pa shpallje paraprake njoftim të kontratës", njësinë e prokurimit, urdhërin për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave. Anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave kanë plotësuar formularine deklaratim.

Gjithashtu me shkresa të veçanta është kërkuar informacion në drejtorinë e Sigurimit Informacionit Klasifikuar (DSIK) lidhur me OE me të paisur me certifikatë sigurie. Është kthyer përgjigje nga DSIK, lidhur me OE të cilët janë të paisur me certifikatë sigurie.

Nga auditimi i gjithë procedurës së prokurimit rezulton se janë zbatuar korrekt gjithë procedurat për realizimin e blerjes, marrjes në dorësim dhe instalimit të paisjeve.

Likuidimi për zbatimin e kontratës është bërë me: USH nr.196, datë 25.09.2019, me vlerë 8,526,000 lekë, (faturat tatimore nr.14, datë 21.08.2019 dhe nr.16, datë 23.09.2019, fletëhyrje

nr.61, datë 21.08.2019) dhe USH nr.227, datë 17.10.2019 me vlerë 2,364,552 lekë (faturë tatimore nr.20, datë 10.10.2019, fletëhyrje nr.64, datë 10.10.2019.

Auditimi i procedurave me blerje me vlera të vogla.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje rezulton se, Në fillim të vitit titullari institucionit ka nxjerrë urdhrin për krijimin e komisionit për blerjet me vlera të vogla dhe për çdo procedurë prokurimi ka dalë urdhri i prokurimit. Procedura është zhvilluar në sistemin elektronik dhe është përcaktuar OE me të cilin është lidhur dhe kontrata për shërbimin e kryer dhe është mbajtur proces verbali i dorzimit të mallit. Madhurat dhe shërbimet janë likuiduar me urdhër shpenzime brenda afatit kohor të përcaktuar.

Nga auditimi i procedurave me blerje me vlera të vogla të ndjekura rezultoi se këto praktika blerje janë realizuar konformë bazës ligjore për prokurimet, nuk u evidentua copëtim fondi për shërbime e mallra të njëjta përgjatë një periudhe buxhetore.

Mbikqyrja për realizimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar

Për mbikqyrjen për realizimin e furnizimit të mallrave e shërbimeve të prokuruar, janë ngritur komisionet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm “Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara”, kjo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kreun “IX”, neni 77, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të MF “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu “III”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

Në procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave, komisioni shprehet mbi marrjen në dorëzim të mallrave konform specifikimeve teknike, ku në procesverbal është listuar e plotë e gjithë sasia e mallrave dhe specifikimeve teknike të dokumentuara në DST.

Sa sipër vlerësojmë se, nga auditimi i sistemit të prokurimeve me fonde publike institucioni është përpjekur dha ka arritur të përvetësojë aktet ligjore, nënligjore e normative që normojnë këtë sistem dhe i ka zbatuar ato në praktikë. Mungesa ka përsa i përket përgatitjes dhe publikimit në sistemin e APP të regjistrave të parashikimit dhe regjistrave të realizimit të prokurimeve me fonde publike.

5. Auditimi i procedurave për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Auditimi i strukturës e organikës së institucionit, respektimi i kërkesave ligjore dhe rregullores për emërimet e personelit të ri dhe transferimet brenda sistemit, përputhshmëria e gradës dhe funksionit.

Strukturat e këtij shërbimi, drejtohen nga Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA. Shërbimi organizohet në departamente dhe drejtori, në nivel qendror dhe drejtori e sektorë, në nivel vendor.

Nga auditimi i strukturës dhe organikës së njësisë shpenzuese SHÇBA u konstatua se:

Për periudhën në auditim (2018, 2019), struktura dhe organika e SHÇBA së ka ndryshur tre herë me Urdhër të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe përbërjen organike të SHÇBA”, sipas periudhave:

- Për periudhën 01.01.2018 deri më datë 01.11.2018, struktura dhe organika është e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.55, datë 21.03.2017 me 117 punonjës nga të cilët (59 punonjës me grada, 49 pa grada dhe 9 punonjës pjesë shërbimit civil.

- Për periudhën 01.11.2018 deri 18.11.2019, struktura është miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.579, datë 26.10.2018, me 126 punonjës nga 117 punonjës aktualë deri më datë 01.11.2018.

- Për periudhën 12.11.2019 e në vazhdim struktura është miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.581, datë 12.11.2019, me 139 punonjës.

Nga auditimi dokumentacionit kjo strukturë nuk ka qënë e plotësuar gjatë kësaj periudhe. Në fund të vitit 2019 rezulton se, organika e miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.581, datë 12.11.2019, me 139 punonjës ka qënë e plotësuar me 126 punonjës. Janë pa u plotësuar 12 pozicione pune sipas organikës të miratuar edhe pse nga strukturat menaxhuese janë bërë përpjekje për plotësim e strukturës. Janë dhe pozicione me status nëpunësi civil të paplotësuara për të cilët nuk janë zhvilluar proceset e konkurimit.

Emërimet dhe lirime nga strukturat e SHÇBA së.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje të punonjësve dhe urdhrave të titullarit të vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për gjithë periudhën janë bërë emërimet, lirime dhe transferime të brendshme me urdhër të titullarit të institucionit. Për të gjitha largimet, emërimet dhe transferimet, janë përpiluar urdhra të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit, për secilin punonjës.

Për vitin 2018, janë liruar gjithsej 7 punonjës dhe janë emëruar katër punonjës dhe për vitin 2019 janë liruar 33 punonjës dhe janë emëruar 34 punonjës. Gjatë këtij viti ka patur dhe shumë lëvizje të brendshme si rezultat i ristrukturimit të SHÇBA së.

Gjetje: Për periudhën në auditim tetë punonjës (katër punonjës me gradë dhe katër punonjës pa grada) janë liruar nga detyra dhe nuk kanë marrë fletëshkëputjen, ndërsa katër punonjës (dy punonjës kanë pezulluar statusin e nëpunësit civil, një punonjëse liruar me vendim të DAP dhe një punonjëse pezulluar nga shërbimi civil) nuk kanë dorëzuar detyrën me proces verbal përkatës, në kundërshtim me pikën 13 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me nenin 42 e 43 të VKM nr.829, datë 03.12.2014 “Për miratimin e rregullores së SHÇBA në MB”, përgjegjësi e strukturës së ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e urdhrave të emërimeve e largimeve.

Gjetje: Në fund të vitit 2019 rezulton se organika e miratuar me urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr.581, datë 12.11.2019, me 139 punonjës ka qënë e plotësuar me 126 punonjës. Janë pa u plotësuar 12 pozicione pune sipas organikës të miratuar. Ky veprim është në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.581, datë 12.11.2019.

-Auditimi për dokumentimin dhe rregullshmërinë e dosjes së personelit dhe vlerësimi i përfomancës së personelit.

Për periudhën objekt auditimi, u audituan vlerësimet e punës për punonjësit e SHÇBA si dhe për punonjësit të cilët ishin në periudhë prove dhe rezultoi se ishte bërë vlerësimi i tyre. U audituan dosjet e punonjësve të emëruar për vitet 2018 dhe 2019 dhe rezultoi se ato ishin të plotësuara në zbatim të nenit 114 të rregullores së SHÇBA, miratuar me VKM nr 829, datë 03.12.2014.

-Auditim mbi ndjekjen dhe zbatimin e procedurave për personelin me masa disiplinore nga procesi i fillimit të ecurisë disiplinore deri në marrjen e vendimit përkatës.

Për periudhën objekt auditimi, për punonjësit e shërbimit, ishin dhënë 28 vërejtje me shkrim për masë disiplinore të rëndë dhe një punonjësi i janë hequr 5 ditë pune”, të cilit i ishin mbajtur nga paga e punonjësit.

Për çdo punonjës është lidhur kontrata individuale në mbështetje të ligjit nr.70/2014 “Për SHÇBA” miratuar me VKM nr.829, datë 03.12.2014. Për rastet të cilat nuk parashikohen në ligjin e SHÇBA, i janë referuar “Kodit të punës të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kontrata pasqyrohen përgjegjësitë dhe detyrimet e punëmarrësve ndaj punëdhënësit dhe të

punëdhënësit ndaj punëmarrësit, përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo punonjës, kushtet e punës, paga e pushimet, përfundimi e zgjidhja e kontratës me afatet përkatëse, etj.

- *Nga auditimi i kryer në drejtim të gradimit, për periudhën e përfshirë në auditim, në zbatim të VKM nr.740 datë 05.11.2014, "Për gradat e personelit të SHÇAB", janë graduar 7 punonjës në Nëntor të vitit 2019, dhe trajtimi me pagë sipas gradës ka filluar në vitin 2020.*

Sa më sipër vlerësojmë se, sistemi i kontrollit në drejtim të menaxhimit burimeve njerëzore ka funksionuar. Janë respektuar aktet ligjore e administrative lidhur me rekrutimin e punonjësve dhe është zbatuar struktura por nuk është plotësuar organika e institucionit.

6. Auditimi i trajtimit të punonjësve me paga e të ardhura të tjera.

Përpilimi dhe administrimi i listëpagesave të pagave dhe trajtimeve të tjera janë bërë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesave të përcaktuara në pikën 69 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Trajtimi i punonjësve me paga dhe të ardhura të tjera, është bërë mbi bazën e dokumentacionit të plotë mbështetës si dhe të listëprezencave të firmosura nga shefi i sektorit të burimeve njerëzore, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto listë prezencave janë të protokolluara dhe me datë. Në listëprezencë është evidentuar prezencë në punë e punonjësve, apo të dhëna mbi arsyet e mosprezencës (me leje të zakonshme, mungon, me raport mjekësor, etj). Sistemi i pagave në njësinë shpenzuese SHÇBA, janë në format elektronik, referuar listëprezencave. Listëpagesat përpilohen e firmosen nga shefi i sektorit të buxhet financës (nëpunësi zbatues), konfirmohen nga sektori i burimeve njerëzore dhe titullari i institucionit (nëpunësi autorizues).

Pagesat përshkruajnë ditët e punës, pagën e grupit, pagën bazë për gradë, shtesë page për funksion, shtesat sipas llojit; vjetërsi, vështirësi, kompensime, shpërblime, etj, ndalesat sipas llojeve, tatimi mbi të ardhurat personale, sigurime shoqërore e shëndetësore.

Listëpagesat e dërguara për pagesë në bankë, rakordojnë me listëpagesat e llogaritjes së pagave dhe me urdhërshpenzimet përkatëse. Listëpagesat e bankës janë nënshkruar nga nëpunësi zbatues dhe miratuar nga nëpunësi autorizues si janë të vulosura me vulën e institucionit. Shuma neto e pagave në përmbledhësen e listëpagesës së bankës përputhej me vlerën e urdhërshpenzimeve për pagat sipas bankave dhe shumën e vlerave neto të listëpagesave të llogaritjes së pagave së secilit punonjës. Listëpagesa e punonjësve konfirmohet në fund e vulosej me vulën e bankës së nivelit të dytë në të cilën punonjësit kanë llogaritë bankare.

U auditua me perzgjedhje dokumentacioni justifikues për pagesat e kryera për pagat e punonjësve (listprezencë, listpagesa etj...) për muajin (Janar, Shkurt dhe Tetor 2018) dhe (Maj, Qershor dhe Nëntor 2019) dhe rezultoi se dokumentacioni për pagesat për pagat, pagesat për bashkëshortet, shtesat e pagave për largësi, pagesa për reform, etj janë të rregullta të plotësuara me gjithë elementet e përcaktuar si dhe me urdhrat e veçantë. Edhe listprezencat rezultojnë se janë të plotësuara në rregull duke paraqitur prezencën në punë për punonjësit. Listprezencat plotësohen nga drejtoritë (sektorët) dhe dorëzohen në sektorin e financës.

Auditimi i saktësisë së trajtimit të punonjësve sipas nivelit të pagave dhe shtesave (mbikohë pune, orë nate, vështirësi shëndeti, kompensimit të privacioneve dhe humbjeve që shkaktohen për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit dhe shpërblime).

Pagesa e punonjësve, për periudhën në auditim është bërë në zbatim të VKM nr.176, datë 08.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.149, datë 18.02.2015".

- Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me grada, janë kryer sipas lidhjes nr.1 që i bashkëngjitet këtij Vendimi dhe paga bazë për gradë e përcaktuar në pikën 1 deri në pikën 10 të lidhjes nr.1, të cilat përputhen me funksionin organik sipas strukturës së miratuar (me gradën që ka fituar). Punonjësit me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, kanë përfituar shtesë për vjetërsi në punë. Përlllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë ka filluar në çastin e marrjes së gradës, sipas ligjit nr.70/2014, “Për SHÇBA në MPB”.

- Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit pa gradë dhe për punonjësit mbështetës janë kryer sipas lidhjes nr.2, të VKM.

Shtesa për vjetërsi në punë për punonjësit e inspektimit dhe punonjësit mbështetës është llogaritur mbi pagën e grupit.

Nga auditimi i pagesës së punonjësve me grada, pa grada dhe të punonjësve mbështetës, u konstatua se për periudhën e audituar me përzgjedhje, pagesat janë kryer në rregull.

Trajtimi me dëmshmëri shëndeti.

Trajtimi me dëmshmëri shëndeti është kryer në zbatim të VKM nr.690, datë 09.12.2012 “Për një ndryshim dhe shtesa në VKM nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” si dhe me urdhrin nr.1408, datë 20.09.2017, për specialistët në sektorin e përgjimit të komunikimeve elektronike sipas shkallës II/f. Janë trajtuar me dëmshmëri shëndeti 8 punonjës mbështetës. Trajtimi financiar është i rregullt dhe me dokumentacion të plotë justifikues.

- *Auditimi i trajtimit të punonjësve me mbi kohë në punë.*

Në lidhje me trajtimin e punonjësve për orë jashtë orarit zyrtar të punës u konstatua se për vitet 2018 e 2019, nuk janë trajtuar me mbikohë pune punonjësit e shërbimit.

Trajtimi i punonjësve me leje të zakonshme.

Trajtimi i punonjësve me leje të zakonshme, është bërë në zbatim të nenit të regullores së SHÇBA, miratuar me VKM nr.829, datë 03.12.2014. Për vitin 2019, është hartuar grafiku i lejeve të zakonshme për punonjësit nga ana e strukturave (drejtori, njësi, sektorë e zyra) dhe një kopje është dërguar në sektorin e burimeve njerëzore i cili ka përgatitur urdhrin e titullarit të institucionit, bashkëngjitur grafiku sipas periudhave dhe funksioneve. Për çdo muaj është ndjekur zbatimi i planifikimit të lejeve për të cilën në çdo rast është miratuar me urdhër të titullarit të institucionit. Për punonjësit të cilët nuk kishin kryer lejen sipas planifikimit ishte bërë anulimi për ta kryer në një periudhë tjetër. Nuk janë kryer pagesa për punonjësit që nuk kanë kryer lejen vjetore.

Auditimi i krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, vlerësimi i dokumentacionit justifikues në përdorimin e tij. Auditimi i shpërblimeve të tjera, për dalje në pension, bazueshmëria ligjore e pagesës së tyre .

Për periudhën e përfshirë në auditim, u auditua i gjithë dokumentacioni justifikues bashkëngjitur urdhërshpenzimeve për trajtimin e punonjësve me ndihma ekonomike dhe shpërblime, në zbatim të pikës 7, të VKM nr.493, datë 06.07.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”. Nga auditimi I kryer rezultoi se:

Ndihma ekonomike, nga artikulli 606.

Për vitin 2018, me urdhër të titullarit të institucionit janë trajtuar me ndihma ekonomike tre punonjës nga 50,000 lekë secili, për sëmundje të rëndë dhe dy familjarë të ish dy punonjësve të cilët kanë ndëruar jetë me nga një pagë mujore.

Për vitin 2019, me urdhër të titullarit të institucionit janë trajtuar me ndihma ekonomike pesë punonjës;

Shpërblime, nga artikulli 606 "Paga"

Janë dhënë shpërblime për punë të mire gjatë vitit me urdhër titullari, 12 punonjësve në shumën 500,546 lekë.

Për punonjësit e trajtuar financiarisht me ndihmë ekonomike dhe shpërblime, dokumentacioni bashkëlidhur është i plotë dhe justifikon veprimin e kryer, në zbatim të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës të SHKB të PMNZSH të forcave të armatosura, SHISH dhe policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës". Për të gjitha rastet e trajtimit me ndihmë ekonomike dhe me shpërblime, është bërë miratimi nga MFE, mbi bazën e kërkesave të bëra nga njësia shpenzuese SHÇBA.

Auditimi i trajtimit të bashkëshorteve me pagë.

Për periudhën objekt auditimi, janë trajtuar me pagë bashkëshorti 2 bashkëshorte, njëra prej të cilave ka përfunduar trajtimin me pagë bashkëshorti pas përfundimit të 15 viteve të punës më datë 01.10.2019. Trajtimi me pagë bashkëshortësh, është kryer në zbatim të ligjit nr.70/2014 "Për SHÇBA në MPB" dhe të VKM nr.776, datë 19.11.2014.

Dokumentacioni në dosje është i plotë për të dy bashkëshortet e punonjësve të SHÇBA.

Trajtimi i punonjësve me largësi,

Punonjësit e SHÇBA, janë trajtuar me shtesë page në zbatim të pikës 1 të VKM nr.776, datë 19.11.2014 "Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MB", ku Drejtori i Përgjithshëm për çdo punonjës të emëruar dhe të transferuar ka nxjerrë urdhrin "Për trajtimin financiar".

Janë trajtuar me pagesë për kompesimin e shpenzimeve të udhëtimit 29 punonjës nga të cilët 9 punonjësve ju është ndërprerë trajtimi financiar në muajin Nëntor 2019, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe konkretisht:

1. *Behar Sulejmani*, emëruar specialist në sektorin e SHÇBA Kukës (drejtoria Kukës Dibër) me urdhër nr.1613, datë 26.10.2017 ka përfituar trajtim për largësi në masën 10,000 lekë. Sipas certifikatës të lëshuar nga Njësia Administrative Selishtë, ky punonjës është me vendbanim në Dibër. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 17.12.2017 deri më 31.10.2019 dhe më datë 01.11.2019 i është ndërprerë largësia me urdhër nr.219, datë 07.11.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Me ndryshimin e strukturës me urdhër të MB nr.579, datë 26.10.2018 ky punonjës është trajtuar me largësi nga data 13.01.2019 deri më datë 01.11.2019 dhe ka përfituar padrejtësisht 85,909 lekë (8.6 muaj x 10,000 lekë).

2. *Bernard Hajdini*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.1622, datë 30.10.2017 në DV të Policisë Vlorë me vendbanim në Tiranë dhe ka filluar trajtimin me urdhër 1622/1, datë 15.11.2017 në masën 10,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.220, datë 07.11.2019 i cili është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 15.11.2017 deri më 31.10.2019 në shumën 235,000 lekë (23.5 muaj x 10,000 lekë).

3. *Besim Bajrami*, emëruar për herë të parë në Shkodër me vendbanim në Tiranë dhe me urdhër nr.112, datë 26.01.2016 është trajtuar me 8,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.221, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 01.02.2016 deri më 31.10.2019 në shumën 360,000 lekë (45 muaj x 8,000).

4. *Vasil Kalluqi*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.1244, datë 01.06.2015 në DV të Policisë Gjirokastër me vendbanim në Sarandë dhe është trajtuar me 5,000 lekë në muaj. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 01.06.2015 deri më 31.10.2019 dhe më datë

01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Me ndryshimin e strukturës me urdhër të MB nr.579, datë 26.10.2018 nuk i takon të trajtohet me largësi nga data 13.01.2019 e në vazhdim dhe ka përfituar padrejtësisht 47,727 lekë (9.5 muaj x 5,000 lekë).

5. *Dritan Dorda*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.127, datë 07.06.2019 në Elbasan me vendbanim në Tiranë trajtimi financiar nga data 24.05.2019 dhe është trajtuar me 5,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi në muajin Qershor të vitit 2019, shuma 6,364 lekë e në vazhdim deri më 31.10.2019 nga 5,000 lekë në total ka përfituar 26,364 lekë (4 muaj x 5,000 lekë + 6,364 lekë).

6. *Emiliano Hajna*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.7, datë 14.01.2019 në Tiranë me vendbanim në Sarandë dhe është trajtuar me 18,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 01.01.2019 deri më 31.10.2019 në shumën 180,000 lekë (10 muaj x 18,000 lekë).

7. *Klodian Ahmeti*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.126, datë 07.02.2019 në Elbasan me vendbanim në Durrës dhe është trajtuar me 8,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 07.06.2019 deri më 31.10.2019 dhe ka përfituar 42,182 lekë (5.3 muaj x 8,000 lekë).

8. *Indrit Hitaj*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.214, datë 07.06.2019 në Elbasan me vendbanim në Tiranë dhe është trajtuar me 5,000 lekë në muaj. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 07.06.2019 deri më 31.10.2019 në shumën 112,000 lekë (muaj x 5,000 lekë).

9. *Jaup Liskendaj*, emëruar për herë të parë me urdhër nr.1100, datë 22.05.2019 në Elbasan me vendbanim në Durrës është trajtuar me 5,000 lekë në muaj nga 24.05.2019. Më datë 01.11.2019 i është ndërprerë me urdhër nr.218, datë 07.11.2019 dhe është njoftuar me shkresë. Ky punonjës ka përfituar largësi nga data 22.05.2019 deri më 31.10.2019 në shumën 26,364 lekë (1,364 lekë + 5 muaj x 5,000 lekë).

Nga 29 punonjës të trajtuar me pagesë për kompesimin e shpenzimeve të udhëtimit 9 punonjës (7 të emëruar për herë të parë dhe 2 punonjës si rezultat i ristrukturimit), kanë përfituar trajtimin financiar në shumën 1,117,017 lekë, të cilëve i është ndërprerë trajtimi me urdhër të titullarit të institucionit dhe janë njoftuar me shkresa në fillim të muajit Nëntor 2019, veprim në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr.776, datë 19.11.2014 “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MB”, ku Drejtori i Përgjithshëm për çdo punonjës të emëruar dhe të transferuar ka nxjerrë urdhrin “Për trajtimin financiar”.

Nga auditimi i dokumentacionit, për ndërprerjen e për trajtimin me largësi, u konstatua se nga njësia shpenzuese SHÇBA, është kërkuar interpretim (shkresa e tyre prot. nr.2161 datë 02.10.2019). Në përgjigje të kësaj shkrese, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm në MB, me shkresë prot nr.7917/1 datë 24.10.2019, shkresë e cila, nuk saktëson nëse punonjësit e përfitojnë apo jo pagesën për largësi, jashtë vendbanimit, (nuk ka të përcaktuar në këtë shkresë në mënyrë taksative që të ndërpritet trajtimi me këtë lloj shpenzimi).

Nga analiza e bazës ligjore që normon këtë shpenzim, sqarojmë se në zbatim të VKM nr.776 datë 19.11.2014, “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 1 e tij sqarohet se “Punonjësi i SHÇBA në MPB, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/saj, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit,).

Në zbatim të këtij Vendimi, pika 9 e tij, ka dalë udhëzimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme nr.675 datë 05.12.2014, “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e pagesës për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 2 “Kategorizimi i përfitimeve”, nën-pika 2.1 përcaktohet që “Përfitimi i pagesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, kur punonjësi i shërbimit caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/të saj, sipas masës së përcaktuar në VKM”.

Gjithashtu sipas VKM nr.829 datë 03.12.2014, “Për miratimin e Rregullores së SHÇBA në MPB, neni 83, pika 7 e tij sqarohet se “Punonjësi i shërbimit caktohet në punë jashtë vendbanimit të vet, përfiton pagesë për kompensim udhëtimit sipas normave të miratuara”.

Në përfundim të analizës së bërë për bazën ligjore që rregullon trajtimin e punonjësve të shërbimit me largësi, sqarojmë se në asnjë nga këto akte, nuk përcaktohet që punonjësit e shërbimit që janë emëruar për herë të parë apo punonjësit që për shkak ristrukturimit të institucionit, ju hiqet e drejta e përfitimit të pagesës për kompensimin e shpenzimeve.

Gjetje: Në muajin Nëntor të vitit 2019, është bërë ndërprerja e përfitimit të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nëntë punonjës të shërbimit. Duke konsultuar bazën ligjore që normon këtë shpenzim, rezulton se ndërprerja e këtij përfitimi, nuk është e bazuar. Ndërprerja është në kundërshtim me VKM nr.776 datë 19.11.2014, “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 1, udhëzimi i MPB nr.675 datë 05.12.2014, “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e pagesës për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MPB”, pika 2 dhe VKM nr.829 datë 03.12.2014, “Për miratimin e Rregullores së SHÇBA në MPB”, neni 83, pika 7.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Bazuar në shkresën e ardhur nga SP nr.7917/1 datë 24.10.2019, paragrafi i fundit theksohet: Trajtimi i punonjësit me pagesë për kompensim udhëtimit dhe përfitimi i dietës sipas legjislacionit lidhet me caktimin e tij në një detyrë tjetër, brenda strukturave të Shërbimit, larg vendbanimit. Në këtë kuptim caktimi i tij në një detyrë tjetër ndodh pasi punonjësi është pjesë e Shërbimit dhe jo kur caktohet për herë të parë në punë.

Nëse Ju si mision e gjykoni se ky interpretim është jo i drejtë mund të rendisni tek rekomandimet dhe detyrat për zbatim. Nga ana jonë do të veprohet në përputhje me rekomandimin e lënë në Raportin Final”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Siç e kemi trajtuar edhe në projekt raportin e auditimit, aktet ligjore ku mbështetet pagesa e kompensimit të udhëtimit janë; (VKM nr.776 datë 19.11.2014, pika 1, VKM nr.829 datë 03.12.2014, neni 83, pika 7 dhe Udhëzimi i MPB nr.675 datë 05.12.2014, pika 2, trajtuar edhe më lart), akte në të cilat kanë të përcaktuar qartësisht kushtet e përfitimit. Shtojmë se në observacionin e paraqitur nga Ju, nuk ka të evidentuar ndonjë akt ligjor që e përcakton ndryshe këtë lloj shpenzimi. Edhe në shkresën e SP që Ju e citoni në observim, nuk evidentohet mosdhënia e kësaj pagese.

Nisur nga sqarimet e mësipërme, observimi i bërë nuk konsiderohet i bazuar, dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Nga grupi i auditëve u auditua dokumentacioni në dosje për secilin punonjës që ka përfituar pagesë për largësi. Në dosje ndodhet dokumentacioni (vërtetimet e lëshuara nga njësia administrative për vendbanimin të cilat shprehen mbi vendbanimin e familjes së punonjësit dhe mbi vendbanimin e vetë punonjësit të trajtuar me largësi, certifikata familjare e lëshuar në datën e fillimit të trajtimit me largësi dhe urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm mbi trajtimin e punonjësit me largësi nga vendbanimi).

Gjetje: Punonjësit që kanë përfituar trajtimin financiar për largësi kanë sjellë të gjithë

dokumentacionin justifikues në datën e fillimit të trajtimit me largësi (vërtetimin e lëshuar nga njësia administrative për vendbanimin, të cilat shprehen mbi vendbanimin e familjes së punonjësit dhe mbi vendbanimin e vetë punonjësit të trajtuar me largësi, certifikata familjare) dokumentacion i cili nuk është rifreskuar deri në fund të vitit 2019, kjo në zbatim të VKM nr.776 datë 19.11.2014, “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA ne MPB”, pika 1, paragrafi i fundit.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Ju dërgua shkresë për rinovim dokumentash për pagesën e largësisë 3 punonjës të Shërbimit që aktualisht e përfitojnë. Bashkëlidhur njoftimi i datës 14.04.2020”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Sipas përcaktimit të bërë nga Ju në observim, keni rënë dakord me rekomandimin e dhënë nga grupi i auditëve, prandaj edhe gjetja e rekomandimi i lënë, nuk ndryshojnë në raportin final.

Auditimi i trajtimit të punonjësve me reformë (pagesë kalimtare).

Për periudhën në auditim (viti 2018 dhe 2019), në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare”, VKM nr.793, datë 24.09.2010 “Për zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare” dhe Aktit Normativ të KM nr.5, datë 10.11.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare...”, janë trajtuar me pagë kalimtare (reformë) 15 ish punonjës.

Gjetje; Për periudhën objekt auditimi, janë trajtuar me pagesë kalimtare gjithsej 15 punonjës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, (3 ish punonjës janë trajtuar me diferencë page për shkak të punësimit në struktura të tjera shtetërore, 11 ish punonjës të cilët janë liruar me kërkesën e tyre dhe 1 punonjëse me motivacionin ”Djegur dekonspiruar”). Në urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm, për punonjësit që përfitojnë pagesën kalimtare është miratuar pagesa me dy paga mujore dhe në vazhdim pas 2 muajsh trajtimi është bërë me 50% të pagës neto dhe është përcaktuar periudha kohore e trajtimit të punonjësve për aq muaj sa vite pune ka (sipas vjetërsisë së shërbimit) dhe jo sipas përcaktimit ligjor të nenit 12, pika 1,2 dhe 3 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, përgjegjësi e strukturës menaxhuese të institucionit e cila edhe pse ka pranuar rekomandimin e lënë nga auditimi për të njëjtin fenomen është mjaftuar vetëm me një kërkesë drejtuar Drejtorisë së Përafrimit me Legjislacionin në MB për të hartuar e miratuar një udhëzim unifikues.

Kjo pagesë kalimtare e punonjësve është konstatuar si gjetje edhe në auditimet e mëparshme dhe është lënë rekomandim nga auditimi dhe i pranuar për t’u zbatuar nga struktura e SHÇBA, përsëri ka vazhduar që në vitin 2018 e 2019 pagesa kalimtare për 12 punonjësit është e përlllogaritur gabim duke u bazuar në vjetërsinë e shërbimit të punonjësit dhe jo në përcaktimin ligjor sipas nenit 12, pikat 1, 2 dhe 3 e ligjit nr.10142, datë 15.05.2009.

Auditimi i ndalesave, deklarimit dhe derdhjes në afat në organet e tatimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, etj.

Listëpagesat, në pjesën e ndalesave, kanë pasqyruar ndalesat mujore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare si dhe tatimin mbi të ardhurat personale që paguhen nga punëmarrësit. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare, që paguhen nga punëmarrësi, është bërë e saktë, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale është bërë e saktë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare të llogaritura për punëmarrësit dhe punëdhënësin, si dhe tatimi mbi të ardhurat e llogaritur për punëmarrësin, ishte derdhur në organet tatimore përkatëse bërë brenda afatit ligjor. Për periudhën e audituar përlllogaritja e tatimit mbi të ardhurat është bërë konform kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Përlllogaritja e detyrimeve të punonjësve për sigurimin suplementar ishte bërë konform kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të RSH” dhe në aktin normativ nr.05, datë 10.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009”. Përlllogaritja e pagesës së sigurimeve shëndetësore është bërë konform kërkesave të përcaktuara në VKM nr.1114, datë 30.07.2008 të ndryshuar me VKM nr.73, datë 12.02.2014.

Auditimi i bazueshmërisë ligjore të pagesës së dietave.

-Shërbimet e kryera nga punonjësit brenda vendit.

Për periudhën në auditim (viti 2018 dhe 2019), punonjësit e institucionit kanë kryer shërbime jashtë vendbanimit të tyre. Pagesat e urdhër shërbimeve janë bërë në zbatim të VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre” Auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të dietave brenda vendit, është kryer për të gjithë periudhën e audituar, deri në pagesën e fundit të kryer nga SHÇBA më 31.12.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, bashkëngjitur urdhër shërbimit të punonjësit rezultoi se shërbimi është kryer mbi bazën e autorizimit të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA “Për angazhim me shërbim të punonjësve të SHÇBA” ku janë përcaktuar data e nisjes dhe e kthimit në institucion, punonjësi që do të kryejë shërbimin, qëllimi i shërbimit.

Bashkëngjitur urdhër shërbimit të hartuar sipas formatit standart dhe të konfirmuar nga nëpunësi udhëtues, nëpunësi zbatues e nëpunësi autorizues janë dhe dokumentat të tjera mbështetëse si fatura tatimore e fjetjes në hotel dhe fatura e kasës fiskale (për rastet e trajtimit me dietë të plotë). Dokumentet mbështetëse janë të hartuara konform akteve ligjore në fuqi.

Për periudhën në auditim, janë trajtuar me dieta brenda vendit punonjësit e SHÇBA së sipas autorizimit të lëshuar nga titullari i institucionit. Për vitin 2018 në shumën 2,651,500 lekë dhe për vitin 2019 në shumën 1,883,680 lekë.

Gjetje: Nga auditimi i autorizimeve të lëshuara nga titullari i institucionit “Për angazhim me shërbim të punonjësve të SHÇBA jashtë vendbanimit të tyre” u konstatua se, rreth 63% e autorizimeve janë protokolluar pas kryerjes së shërbimit. (për vitin 2018 nga 340 autorizime janë protokolluar pas kryerjes së shërbimit 191 autorizime ose 56% e tyre dhe për vitin 2019 nga 379 autorizime janë protokolluar 265 ose 70% e tyre). Në 6 raste autorizimi është protokolluar në datë 30.05.2018 ndërkohë që shërbimi është kryer nga data 16 deri më 20.04.2018, në 7 raste autorizimi është protokolluar në datë 01.08.2018 ndërkohë që shërbimi nga dy punonjës është kryer nga data 18 deri më 20.04.2018, nga dy punonjës është kryer nga data 04 deri më 06.07.2018, nga dy punonjës është kryer nga data 25 deri më 30.06.2018, nga një punonjës nga data 28 deri më 30.06.2018 dhe në dy raste autorizim i është protokolluar në datë 07.11.2018 ndërkohë që shërbimi është kryer nga data 01 deri më 03.10.2018.

- Shërbimet e kryera nga punonjësit jashtë vendit.

Për periudhën në auditim (vitet 2018, 2019), punonjësit e institucionit kanë kryer shërbime jashtë vendit. Pagesat e urdhër shërbimeve janë bërë në zbatim të VKM nr.870, datë

14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të dietave jashtë vendit, është kryer për të gjithë periudhën e audituar, deri në pagesën e fundit të kryer nga SHÇBA më 31.12.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se shërbimi është kryer mbi bazën e urdhrimit të Ministrit të Brendshëm “Për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të punonjësve të SHÇBA” ku janë përcaktuar shteti, data e nisjes dhe e kthimit në institucion, punonjësi që do të kryejë shërbimin. Bashkangjitur urdhër shërbimit të konfirmuar nga nëpunësi udhëtues, nëpunësi zbatues e nëpunësi autorizues janë dhe dokumentat të tjera mbështetëse të cilat janë të hartuara konform akteve ligjore në fuqi.

Për vitin 2018, janë kryer shërbime jashtë vendit nga punonjësit në shumën 2.429 euro nga 3.545 euro që janë tërhequr me urdhërshpenzim nga banka të cilat janë bërë hyrje në arkën e institucionit.

Për vitin 2019, janë kryer shërbime jashtë vendit në shumën 2.309.5 euro nga totali 3,500 euro tërhequr me urdhërshpenzimi.

Sa më sipër vlerësojmë se, sistemi i kontrollit në drejtim të trajtimit të punonjësve me paga, shtesa mbi pagë e të ardhura të tjera si dhe ndalesat e bëra për sigurimet shoqërore, shëndetësore e suplementare, janë bërë në zbatim të akteve ligjore, nënligjore e normative që normojnë këtë fushë. Staf i është i njohur me këto akte dhe në përgjithësi i ka zbatuar ato në praktikë.

7. Auditimi i transaksioneve nëpërmjet bankës.

Auditimi i transaksioneve me bankë, rregullariteti i veprimeve me bankën, dokumentacioni justifikues i veprimeve, regjistrimi në ditarët e llogarisë kontabël.

Auditimi i kontrollit paraprak të dokumentacionit që kalon në financë për likuidim (sistemi i kontrollit para likuidimit). Auditimi për likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve dhe evidentimi i efekteve financiare për vonesat e krijuara në likuidim (nëse ka), adresimi i përgjegjësive përkatëse.

U audituan të gjitha veprimet me bankën për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019 të cilat janë të dokumentuara me urdhërshpenzime përkatëse, të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe të vulosura nga dega e thesarit të rrethit. Regjistrimi i transaksioneve në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve është bërë në mënyrë elektronike sipas kronologjisë së veprimeve ekonomike dhe vlerat e regjistruara në llogari për çdo fund periudhe janë të kuadruara si për llogaritë debitore dhe ato kreditore. Për çdo fund periudhe mujore, shuma e shpenzimeve të regjistruara të likuiduara është e kuadruar me ditarët analitikë të llogarive. Nga auditimi i ditarit të transaksioneve me bankë dhe ditarit të shpenzimeve rezultoi se është mbajtur i rregullt dhe në të janë azhornuar të gjitha urdhërshpenzimet e kryera për të gjithë periudhën. Ditari është i kuadruar për të gjithë llogaritë e shpenzimeve, konform planit të shpenzimeve të miratuara.

Shpenzimet e likuiduara nëpërmjet bankës përputhen me shpenzimet e paraqitura në situacionin vjetor të shpenzimeve të konfirmuara në degën e thesarit të rrethit.

Kryesisht veprimet e bëra nëpërmjet dokumentacionit të bankës janë pagesat për shpenzimet sipas situacionit buxhetor në artikujt kryesor; “Paga shpërblime personeli”, “Sigurime Shoqërore, shëndetësore e suplementare”, “Shpenzime operative”, “Shpenzime për buxhetet familjare dhe individët” dhe “Shpenzime për rritjen e aktiveve”.

Urdhërshpenzimet ishin të plotësuara me të gjitha të dhënat e kërkuara në formularin “Tip” të miratuar, kishin bashkëlidhur dokumentacionin justifikues sipas natyrës së shpenzimit si; dokumentacionin e procedurës së prokurimit, kontratën, faturën tatimore të shitjes, proces verbalin e marrjes në dorëzim të mallit dhe të shërbimit, fletëhyrjen e magazinës, etj.

Dokumentacioni justifikues dhe mbështetës i pagesave ishte i plotë dhe i bazuar në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Për vitin 2018, janë kryer me USH 275 transaksione (duke filluar nga nr.1, datë 03.01.2018 deri tek nr.275, datë 24.12.2018).

Sipas natyrës së çeljes së fondeve rezulton se janë likuiduar në total 189,785,586 lekë;
- Për paga 117,051,977 lekë, për sigurimet shoqërore 19,300,260 lekë, mallra e shërbime 20,597,593lekë, 606 “Transferta” 2,526,204 lekë dhe investime vlera 30,309,552 lekë.
Nga shpenzimet e funksionimit nga artikulli 602 janë likuiduar shpenzime nga të tretët,në total 480,587 lekë (për shërbime postare 131,217 lekë, telefon dhe internet 349,370lekë).

Për vitin 2019, janë kryer me USH 288 transaksione (duke filluar nga nr.1, datë 07.01.2019 deri tek nr.288, datë 31.12.2019).

Sipas natyrës së çeljes së fondeve rezulton se janë likuiduar në total 179,874,571 lekë;
- Për paga 120,690,805 lekë, për sigurimet shoqërore 19,999,237 lekë, mallra e shërbime 21,223,177 lekë, 606 “Transferta” 6,969,760 lekë dhe investime vlera 10,991,592 lekë.
Nga shpenzimet e funksionimit nga artikulli 602 janë likuiduar shpenzime nga të tretët, në total 649,785 lekë (për shërbime postare 211,329 lekë, telefon dhe internet 438,456lekë).
Për periudhën në auditim, për shërbime postare likuidimi kryhet sipas faturave të ardhura nga posta shpenzim i kryer brenda afatit dhe për shërbime komunikimi me telefon dhe internet likuidimi i shpenzimeve kryhej në bazë të faturës të cilat janë të konfirmuara nga drejtoria e shërbimeve mbështetëse. Nuk kishte detyrime të akumuluar për këtë shërbim.

Gjetje: Sektori i buxhet financës ka likuiduar me urdhërshpenzimi nr.215, 216, 217, 218 219, datë 11.10.2019, gjoba të paguara me vonesë nga institucioni në shumën 25,000 lekë (gjobë për deklarim të vonuar punëmarës të rinj në vitin 2017 dhe 2019), veprim në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore RSH” i ndryshuar, *përgjegjësi e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues sipas periudhave (Shkurt, Prill, Nëntor 2017 dhe Janar, Maj 2019).*

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Me urdhër të MFE, në muajin Tetor 2019, është autorizuar Dega e Thesarit të mos miratojë asnjë lloj shpenzimi për asnjë njësi shpenzuese pa rakoduar me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve në lidhje me gjodat që rezultojnë në sistemin online të tatimeve dhe pa i likuiduar ato. Nga rakordimi i bërë nga ana jonë kemi konstatuar 5 gjoba në vlerën 25,000 lekë në adresë të institucionit tonë për deklarim të vonuar të personelit të pranuar në Shërbim. Regjistrimi me vonesë ka ardhur si shkak i faktit se urdhërat e emërimeve mbajnë të njëjtën datë protokollimi dhe datë fillim marrdhënie pune, duke bërë kështu që në sektorin tonë të vijmë në ditën që fillon marrdhënia e punës ose një ditë më vonë dhe në këtë mënyrë ka shkatuar regjistrim me vonesë 1- 2 ditë. Likuidimi i këtij detyrimi është bërë në llogaritë e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, për mbarëvajtjen e punës së Institucionit”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Për observimin e bërë sqarojmë se si gjetje qëndron, (pra është likuiduar shuma 25,000 lekë për gjoba). Observimi i bërë nga Ju, nuk ka bazë ligjore. Grupi i auditëve ka rekomanduar që gjetja të analizohet, të gjenden fajtorët (nëse ka) në mënyrë që të mos përsëritet ky fenomen në të ardhmen, prandaj observimi i bërë nuk merret në konsideratë dhe nuk reflektohet në Raportin Final.

- Shpenzime për vendimet gjyqësore:

Për periudhën në auditim (viti 2018, 2019), nga auditimi i dokumentacionit justifikues për pagesat e likuiduara rezultoi se për katër raste likuidimi të vendimeve gjyqësore të Gjykatës

Administrative të Apelit Tiranë e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Nga SHÇBA janë ndjekur shkallët e gjykimit dhe në përfundim të këtyre vendimeve është përgatitur dokumentacioni për kryerjen e pagesës të ish punonjësve të larguar nga puna. Nga titullari i institucionit, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative para likuidimit. Janë likuiduar katër vendime gjyqësore të formës së prerë në shumën 2,752,548 lekë (2,575,774 lekë për katër ish punonjës të larguar nga puna dhe 176,774 lekë shpenzime përmbarimore).

Gjetje: Në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.3419, datë 13.07.2017, me USH nr.235, datë 28.10.2019 është likuiduar përmbaruesi privat “Kodra Bailif Service shpk”, në shumën 292,628 lekë ku përfshihen edhe shpenzimet përmbarimore 26,400 lekë të likuiduara. Likuidimi është bërë pa patur faturën tatimore, (likuidimi datë 28.10.2019 fatura datë 01.11.2019), në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 61 e tij dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Likuidimi i detyrimit të lindur në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.3419, është realizuar konform Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyren e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit” si dhe udhëzimit të përbashkët mes MF dhe MD nr.385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi gjyqësor privat”. Në urdhër shpenzimit nr.235, datë 28.10.2019, është detajuar shpenzimi prej 292,628, lekë konkretisht në shumën 266,228 lekë që përfiton ish punonjësi bazuar në vendimin e gjykatës si dhe shpenzimin në favor të zyrës së përmbarimit në shumën prej 26,400 lekë (siç mund të verifikohet në udhëzimin e sipërcituar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për shumën 100,000 - 300,000 lekë tarifa fikse që i detyroheni zyrës përmbarimore është në shumën prej 22,000 lekë pa tvsh, shumë për të cilën hartohet dhe fatura e tvsh). Gjetja juaj i referohet pikës 61 të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, ku citohet se “.... njësia shpenzuese është e detyruar të procedojë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimit menjëherë pas marrjes së faturës nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/apo marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës”.

Në këtë rast nuk kemi blerë asnjë mall apo shërbim por kemi likuiduar një detyrim të bazuar në tërë aktet ligjore në fuqi dhe e kemi shoqëruar me dokumentet e duhura vërtetuese dhe justifikuese”.

Përgjigja e grupit të auditëve. Për observimin e bërë sqarojmë se likuidimi është bërë pa patur faturën tatimore, (për të cilën bini dakort). Në nenin 61 përcaktohet që “.....likuidimi kryhet “.... menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit”. Përmbarimi është një shërbim dhe si i tillë, likuidimi bëhet pas përpilimit të faturës tatimore. Për këto arsye, observimi i bërë nuk merret në konsideratë dhe nuk reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

Gjetje: Për likuidimin e katër vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerë 2,752,548 lekë, është bërë gjurma e auditimit sipas formatit tip, por nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative para likuidimit të këtyre vendimeve. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 62 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe pikën 38 të Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”. Mbajnë përgjegjësi administrative për këto veprime nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues sipas periudhave.

8. Auditimi i pagesave të kryera me arkë.

Auditimi i dokumenteve justifikues për transaksionet e kryera me arkë ose bankë për përdorimin e fondit të posaçëm. Auditimi i fondit të posaçëm, u krye në zbatim të Autorizimit të Ministrit nr.125, datë 28.01.2020, saktësia e hartimit të pagesave, rakordimi i arkës. Përputhshmëria e shpërblimit sipas kompetencës dhe administrimit i vendimeve, vendimit për pagesë, urdhër pagimi, dëftesë pagimi, dëftesa përfundimtare dhe mandat pagesa.

Nga auditimi dokumentacionit të arkës u konstatua se për periudhën objekt auditimi me urdhër dhe autorizim të titullarit janë kryer 15 transaksione (urdhërshpenzime), të cilat janë bërë hyrje në arkën e SHÇBA në shumën 2,000,000 lekë, 9.045 euro dhe 2.250 USD

Urdhërshpenzimit i është bashkëlidhur urdhri dhe autorizimi i lëshuar nga titullari institucionit për të tërhequr nga banka para dhe valutë nga punonjësi i ngarkuar për kryerjen e veprimeve me arkë. Valuta është bërë hyrje në arkë për shpenzime udhëtimi e dieta për punonjësit që kanë kryer shërbimë jashtë vendit. Këto shpenzime janë trajtuar te sistemi i pagave (udhëtime dieta).

Sqarojmë se për auditimin e veprimeve me arkë, të kryera për përdorimin e fondit të posaçëm, trajtimi bëhet në një akt të veçantë, për arsye se përdorimi i këtij fondi është "Sekret".

9. Auditimi i mbajtjes dhe funksionimit të sistemit kontabël.

Nga auditimi i kryer për mbylljen e pasqyrave financiare vjetore (bilancit kontabël) për vitet buxhetore 2018 dhe 2019, funksionimin e mbajtjes së llogarive kontabël, evidentimit e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrimit të tyre në dhënien e llogarisë vjetore rezultoi se bilancetekëtyre viteve janë përpiluar, miratuar dhe dorëzuar, brenda afateve.

Nga auditimit i pasqyrave financiare, për vitin buxhetor 2018, rezultoi se :

Një kopje e pasqyrave financiare vjetore (bilancit), të vitit 2018, është dërguar me shkresë përcjellëse nr.392, datë 28.02.2019 "Dërgohen pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018" pranë degës së thesarit të rrethit dhe me shkresën nr.515 datë 15.03.2019, një kopje është dërguar pranë MB (Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse).

Në mënyrë analitike u bë analizimi i pasqyrës financiare dhe u konstatua se,

Aktivi i bilancit

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri "Mjete monetare dhe ekujalent të tyre", është zero lekë, pra nuk ka mjete monetare në thesar dhe as në arkë.

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri "Gjendje inventari qarkullues", është në shumën 1,172,203 lekë shumë e cila është "Inventar i imët". Në krahasim me fundin e vitit 2017, gjendje e inventarit qarkullues, nuk ka ndryshuar.

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri "Llogari të arkëtueshme", është në shumën 12,227,922 lekë. Në krahasim me një vit më parë, ky post është pakësuar për vlerën 264,206 lekë. Vlera e pakësuar përfaqëson pakësim e llogarisë "Të tjera operacione me shtetin debitor" për gjithë shumën 264,206 lekë (nga 12,196,693 lekë në fund të vitit 2017, në fund të vitit 2018 është 11,932,487 lekë).

Llogaria "Debitorë të ndryshëm", është në shumën 295,435 lekë dhe për vitin ushtrimor 2018 nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Vlera prej 295,435 lekë, përbën detyrimet e tetë personave privatë.

Në llogarinë "Debitorë të ndryshëm", është një vlerë prej 295,435 lekë, që janë detyrimet debitore të tetë personave privatë. Për këto tetë persona, për vitin 2018, nuk është arkëtuar asnjë vlerë. Nga këto persona, për pesë prej tyre (katër punojnë në SHISH dhe një në Polici,

janë dërguar shkresa zyrtare por nuk është marrë përgjigje. Për tre persona janë dërguar shkresat në qendrën e banimit, por nuk është marrë përgjigje.

- Posti i aktiveve afatgjata, është në shumën 66,134,999 lekë, vlerë e cila përbëhet vetëm nga aktive afat gjata materiale. Në krahasim me vitin 2017, këto aktive kanë pësuar rritje në shumën 13,253,533 lekë. Analiza e ndryshimeve të aktiveve afatgjata materiale, bëhet në një paragraf të veçantë të këtij materiali.

Në total aktivi i bilancit është **79,535,124** lekë.

Pasivi Bilancit,

- Posti i pasiveve (detyrimet), zëri “*Llogari të pagueshme*”, është në shumën 11,932,487 lekë. Kjo shumë përbëhet nga :

Llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*” , vlera 7,427,576 lekë janë detyrimet e Institucionit ndaj punonjësve për pagën e muajit Dhjetor 2017.

Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*”, vlera 792,772 lekë vlerë e cila përfaqëson ndalesat e bëra punonjësve për tatimin mbi të ardhurat personale në muajin Dhjetor 2017 dhe të paderdhur në buxhet.

Llogaria 435 “*Sigurimet shoqërore*”, vlera 2,496,943 lekë, vlerë e cila përfaqëson arkëtimet e sigurimeve shoqërore në muajin Dhjetor 2017 e të paderdhur në buxhet.

Llogaria 436 “*Sigurimet shëndetësore*”, vlera 318,462 lekë, vlerë e cila përfaqëson arkëtimet e sigurimeve shëndetësore në muajin Dhjetor 2017 e të paderdhur në buxhet.

Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” vlera 896,734 lekë, vlerë e cila përfaqëson detyrimet e institucionit për faturat e telefonisë, (fikse dhe celulare), fatura e postës dhe dietat e punonjësve, të cilat janë të llogaritura si shpenzime të muajit Dhjetor 2017 dhe likuidimi është bërë në muajin Janar 2018.

Llogaria 475 “*Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse*” vlera 295,435 lekë që përfaqëson detyrimin e tetë personave fizikë privatë, për detyrime ndaj buxhetit të shtetit.

- Posti i pasiveve (fondet e veta), zëri “*Fondi i konsoliduar*” me 31.12.2018, është në shumën 67,307,202 lekë. Në krahasim me vitin 2017, ka shtesë për shumën 13,253,533 lekë, vlerë kjo e pasqyruar dhe e kuadruar me aktivin e bilancit me vlerat respektive të llogarive të aktiveve dhe të pasqyruara e relatuar në pasqyrën nr.8 të lëvizjes së fondeve, për shtesa dhe pakësime të fondeve bazë.

Për vitin buxhetor 2018, shtesat e aktiveve janë në shumën 30,309,552 lekë, gjithë vlera është nga burime të brendshme (buxheti i shtetit). Auditimi për blerjen e aktiveve me fonde publike, (burimet e brendshme) trajtohet në kapitullin e prokurimeve me fonde publike.

Totali i pasivit me datën 31.12.2015 është **79,535,124lekë**.

Nga auditimit i pasqyrave financiare, për vitin buxhetor 2019, rezultoi se :

Një kopje e pasqyrave financiare vjetore (bilancit), të vitit 2019, është dërguar me shkresë përcjellëse pranë degës së thesarit të rrethit dhe pranë MB (Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse).

Në mënyrë analitike u bë analizimi i pasqyrës financiare dhe u konstatua se,

Aktivi i bilancit

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri “*Mjete monetare dhe ekujalent të tyre*”, është zero lekë, pra nuk kaq mjete monetare në thesar dhe as në arkë.

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri “*Gjendje inventari qarkullues*”, është në shumën 1,300,313 lekë shumë e cila është “*Inventar i imët*”. Në krahasim me fundin e vitit 2018, gjendje e inventarit qarkullues, është shtuar për shumën 128,110 lekë, vlerë e cila është pasqyruar saktë në llogarinë e ndryshimeve të gjendjes së inventarit.

- Posti i aktiveve afatshkurtëra, zëri “Llogari të arkëtueshme”, është në shumën 13,595,249 lekë. Në krahasim me një vit më parë, ky post është shtuar për vlerën 1,367,327 lekë. Vlera e shtuar përfaqëson shtesë në llogarinë “Të tjera operacione me shtetin debitor” për shumën 1,072,958 lekë (nga 11,932,487 lekë në fund të vitit 2018, në fund të vitit 2019 është 13,005,445 lekë) dhe shtesë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në shumën 294,369 lekë, (nga 295,435 lekë në fund të vitit 2018, në fund të vitit 2019 është 589,804 lekë).

Gjetje: Për aktivitetin e periudhës së vitit 2019, nuk është arkëtuar asnjë vlerë debitore për llogari të buxhetit të shtetit. Për këtë vit buxhetor, është shtuar shuma debitore për 294,369 lekë për dy persona debitorë, (A. C. shuma 72,885 lekë dhe A. G. për shumën 221,484 lekë).

Vlera e shetuar në këtë llogari, janë për A. C shuma 72,885 lekë pasi është deklaruar debitor me urdhër nr.1104/4, datë 13.09.2019, për arsye se ka përfituar trajtim financiar me pagë për gradë si “Drejtues” konform urdhrin nr.1104 datë 22.05.2019, sipas të cilit është pranuar në SHÇBA. Meqenë se kjo gradë i është dhënë gabimisht (nga konvertimi gradës policore kryekomisar), është bërë korigjimi i gabimit me urdhrin nr.1104/3, datë 13.09.2019. Me këto dy urdhra është njohur punonjësi i cili ka pranuar që shuma e përfituar padrejtësisht t’i mbahet nga paga. Ka filluar të mbahet detyrimi debitor në vivin 2020.

A. G. është regjistruar debitorë për shumën 221,484 lekë, vlerë që përfaqëson vlerën e mbetur të pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiVvifi”, vlera fillestare 700,000 lekë (blerë e krijuar me pagesë në vitin 2014), paisje e cila nga komisioni i inventarizimit të aktiveve në vitin ushtrimor 2018, është konstatuar si mungesë. Për këtë diferencë, trajtimi bëhet në paragrafin e auditimit të inventarizimit të aseteve.

- Posti i aktiveve afatgjata, është në shumën 50,739,827 lekë, vlerë e cila përbëhet vetëm nga aktive afat gjata materiale. Në krahasim me vitin 2018, këto aktive kanë pësuar pakësim në shumën 15,395,172 lekë. Analiza e ndryshimeve të aktiveve afatgjata materiale, bëhet në një paragraf të veçantë të këtij materiali.

Në total aktivi i bilancit është **65,635,389** lekë.

Pasivi Bilancit,

- Posti i pasiveve (detyrimet), zëri “Llogari të pagueshme”, është në shumën 13,005,445 lekë. Kjo shumë përbëhet nga :

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” , vlera 8,614,297 lekë janë detyrimet e Institucionit ndaj punonjësve për pagën e muajit Dhjetor 2018.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”, vlera 928,819 lekë vlerë e cila përfaqëson ndalesat e bëra punonjësve për tatimin mbi të ardhurat personale në muajin Dhjetor 2018 dhe të paderdhura në buxhet.

Llogaria 435 “Sigurimet shoqërore”, vlera 2,892,437 lekë, vlerë e cila përfaqëson arkëtimet e sigurimeve shoqërore në muajin Dhjetor 2018 e të paderdhur në buxhet.

Llogaria 436 “Sigurimet shëndetësore”, vlera 364,721 lekë, vlerë e cila përfaqëson arkëtimet e sigurimeve shëndetësore në muajin Dhjetor 2018 e të paderdhur në buxhet.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” vlera 205,171 lekë, vlerë e cila përfaqëson detyrimet për shpenzimet për ujë, shpenzime postare, etj, të faturuara në muajin Dhjetor 2018 dhe të palikuiduara nga institucioni. Këto detyrime janë likuiduar në muajin Janar 2019.

Llogaria 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” vlera 589,804 lekë që përfaqëson detyrimin e dhjetë personave fizikë privatë ndaj buxhetit.

- Posti i pasiveve (fondet e veta), zëri “Fondi i konsoliduar” me 31.12.2019, është në shumën 52,040,140 lekë. Në krahasim me vitin 2018, ka pakësim për shumën 15,262,062 lekë, vlerë kjo e pasqyruar dhe e kuadruar me aktivin e bilancit me vlerat respektive të llogarive të

aktiveve dhe të pasqyruara e relatuar në pasqyrën endryshimeve në aktive, fondet neto, për shtesa dhe pakësime të fondeve bazë.

Për vitin buxhetor 2019, shtesat e aktiveve janë në shumën 17,169,287 lekë, prej të cilave nga burime të brendshme (buxheti i shtetit) vlera 11,119,702 lekë dhe nga donacione (AAGJ), vlera 6,049,585 lekë. Auditimi për blerjen e aktiveve me fonde publike, (burimet e brendshme) trajtohet trajtohet në kapitullin e prokurimeve me fonde publike ndërsa donacioni trajtohet në materialin e auditimit për fondet sekrete.

Totali i pasivit me datën 31.12.2015 është **65,635,389**lekë.

8.2 Analiza e lëvizjes së aktiveve afatgjata materiale.

Nga auditimi i lëvizjes së aktiveve afatgjata materiale **për vitin buxhetor 2018**, rezultoi se këto aktive janë shtuar për shumën 13,253,533 lekë, (gjëndja në fillim të vitit 2018 është 54,053,669 lekë, shtesat me vlerë 13,253,533 lekë, gjëndja në fund të vitit 2018 është 67,307,202 lekë.

1. Shtesat

Blerë e krijuar me pagesë.

- Shtesa në llogarinë 215 “Mjete transporti” është shtuar për shumën 29,402,892 lekë dhe përfaqëson blerjen e 15 automjeteve transporti, me fonde të akorduara nga buxheti i shtetit. Procedura e lidhjes dhe zbatimit të kontratës, pas autorizimit nga MB, pasi është kryer blerje e përqëndruar, trajtuar të sistemi i prokurimeve për vitin 2018.

- Shtesa në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, në shumën 906,660 lekë, vlerë e cila përfaqëson blerjen pajisje zyre (8 printera e 3 fotokopje), bërë hyrje më fletëhyrje nr.54, datë 20.12.2018.

2. Pakësime

Pakësimet janë kalime kapitale. Për vitin 2018, nga ana e institucionit të SHÇBA, janë bërë kalime kapitale në QSHAMT, mjete transporti me vlerë 7,663,500 lekë. Kalime kapitale të automjeteve, janë bërë në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Brendshëm. Për këtë vit buxhetor, nuk janë bërë nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale.

Nga auditimi i lëvizjes së aktiveve afatgjata materiale **për vitin buxhetor 2019**, rezultoi se aktivet afatgjata janë pakësuar për shumën 22,439,392 lekë, (gjëndja në fillim të vitit 2019 është 100,227,171 lekë, shtesat janë 17,041,177 lekë, pakësimët janë 22,439,392, gjëndja në fund të vitit 2019 është 94,828,956 lekë.

1. Shtesat

Blerë e krijuar me pagesë. Shtesa në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, në shumën 10,991,592 lekë, vlerë e cila përfaqëson “Blerje pajisje përgjimi” në shumën 10,890,552 lekë, bërë hyrje më fletëhyrje nr.61, datë 21.08.2019 dhe nr.64, datë 10.10.2019 si dhe shuma prej 101,040 lekë “Blerje pajisje zyre” (2 printera), bërë hyrje me fletëhyrjen nr.68, datë 27.11.2019.

- Donacione në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, në shumën 6,049,585 lekë, vlerë e cila përfaqëson kalimin pa pagesë të paisjeve speciale, donacione nga “Giz office” në vlerën 2,230,800 lekë, si dhe donacion nga ICITAP në vlerën prej 3,818,785 lekë.

2. Pakësime

Kalim kapital. Për vitin 2019, nga ana e institucionit të SHÇBA, janë bërë kalime kapitale në QSHAMT, mjete transporti me vlerë 21,739,392 lekë. Kalimi kapital, është bërë në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Brendshëm dhe janë të dokumentuara rregullisht.

Gjithashtu, pakësime ka në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, shuma 700,000 lekë, që është vlera fillestare e paisjes së përgjimit që ka dalë diferencë inventari.

Për këtë vit buxhetor, nuk janë bërë nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale.

8.3. Mbajtja e regjistrit të aktiveve.

Nga auditimi i kryer në drejtim të përpilimit të regjistrit të aktiveve, rezultoi se në këtë njësi shpenzuese, është mbajtur libri analitik i aktiveve ku është përcaktuar :

- Numri dokumentit dhe data e hyrjes së aktivit.
- Përshkrimi i aktivitet (lloji i aktivitet).
- Vlera fillestare e aktivitet.
- Data e hyrjes në përdorim.
- Vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerë aktivitet dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi.
- Vlera e akumuluar e amortizimit të aktivitet.
- Vlera e mbetur e aktivitet.
- Personi përgjegjës material, etj.

Aktivet afatgjata materiale, shumica janë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me vlerë 94,447,356 lekë. ndërsa në llogarinë 215 “Mjete transporti”, janë dy motocikleta, me vlerë 381,600 lekë. Nuk ka zëra të tjerë aktivesh në përdorim.

8.4. Regjistrimi i ndërtimeve dhe trojeve në ZVRPP e rretheve.

Njësia shpenzuese SHÇBA, nuk ka në përdorim toka troje, terrene apo ndërtesa e konstruksione, kështu që nuk ka ndërtim e troje për të regjistruar në ZVRPP.

8.5. Inventarizimi i pasurisë dhe nxjerrjet nga përdorimi.

Në zbatim të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, i ndryshuar, Udhëzimit e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, i ndryshuar dhe udhëzimit të MB nr.226 datë 08.05.2015, “Për përcaktimin e përgjegjësisë në menaxhimin e aktiveve“, është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së SHÇBA.

Për vitin 2018, me urdhrin e titullarit nr.6, datë 10.01.2019, “Për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve“, i ndryshuar me urdhrin nr.61/1 datë 21.01.2019, është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga tre veta, (Sterio Golloshi kryetar, Artan Kola e Gentian Hoxha anetarë). Në këtë urdhër, përcaktohet që komisioni i mësipërm, duhet të kryejë inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre (aktive të qëndrueshme, inventar ekonomik, inventar i imët, etj), në depo dhe në përdorim.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin fizik të aseteve mbi bazën e fletë inventarëve të përpiluar nga sektori i financës.

Komisioni i inventarizimit ka fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, në përputhje me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, i ndryshuar neni 83 i tij.

Inventarizimi i aseteve është kryer në sasi, çmim dhe në vlerë dhe komisioni ka përpiluar procesverbalet përkatëse. Procesverbalet e inventarizimit të aseteve, janë të firmosura rregullisht nga anëtarët e komisionit dhe nga personi përgjegjës material.

Komisioni i inventarizimit të aktiveve, ka përgatitur e nënshkruar fletët e inventarit përkatës dhe pas krahasimit të gjendjes kontabile me gjendjen fizike, ka rezultuar mungesa e një paisje “Sistem regjistrimi UniFiVVifi“ me vlerë fillestare 700,000 lekë.

Kjo paisje, është blerë me fonde të akorduara nga buxheti i shtetit, në vitin 2014. Nga auditimi i dokumentacionit, që disponon zyra e financës dhe kartoteka e këtij institucioni, rezultoi se, fatura e OE shitës, nr.759 datë 14.11.2014, nuk është e firmosur nga asnjë përfaqësues i institucionit si marrës në dorëzim. Gjithashtu, nuk ka komision të ngritur me urdhër të titullarit, për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të këtij aktivi. Kjo paisje, është bërë hyrje me fletëhyrjen nr.90 datë 14.11.2014, firmosur fletëhyrja vetëm nga ish

magazinerja Ariada Girengir dhe bashkëlidhur kësaj fletëhyrje nuk ka procesverbal kolaudimi dhe marrje në dorëzim të kësaj paisje.

Paisja është bërë dalje me fletë daljen nr.330 datë 30.12.2014, si marrës në dorëzim është Gentjan Hoxha. Për këtë fletëdalje, pretendohet nga marrësi në dorëzim G. H. se nuk është firma e tij. Për këto arsye, është përgatitur dokumentacioni përkatës dhe është dërguar për hetim në prokurorinë pranë rrethit gjyqësor të shkallës së parë Tiranë. Nuk kanë përfunduar akoma hetimet.

Komisioni i invenatrizimit, ka përpiluar procesverbalin e kryerjes së inventarit me datën 11.02.2019, proces verbal në të cilin kanë firmosur të tre anëtarët e komisionit. Komisioni i inventarizimit të aktiveve, ka përgatitur relacionin për kryerjen e inventarizimit dhe në zbatim Udhëzimit e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, i ndryshuar pika 85, germa „c“ e tij ku përcaktohet që komisioni ka përgjegjësinë që “Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”. Por ky komision e ka dërguar tek titullari i institucionit (nëpunësi autorizues) këtë raport me prot. nr.61/3, datë 13.07.2019, pra pas pesë muajsh.

Gjetje: Komisioni i inventarizimit të aktiveve, i përbërë nga S. G. kryetar, A. K. e G. H. anëtarë, ka përfunduar inventarizimin me datën 11.02.2019. Raportin lidhur me kryerjen e inventarizimit, e ka dërguar tek nëpunësi autorizues, me prot. nr.61/3, datë 13.07.2019, pra pas pesë muajsh. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, i ndryshuar pika 85, germa „c“ e tij dhe ngarkon me përgjegjësi tre anëtarët e komisionit.

Gjetje: Vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor prej 221,484 lekë, vlerë që përfaqëson vlerën e mbetur (vlera e aktivitet pas zbritjes së amortizimit vjetor në masën 25% çdo muaj) të pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiVvifi“ me vlerë fillestare 700,000 lekë. Nga dokumentacioni që disponon institucioni i SHÇBA, nuk vertetohet që kjo paisje ka dalë në përdorim. Për këtë arsye, vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor, nuk është e saktë.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Kontabilizimet e bëra nga ana e financës, bazohen në dokumentet që disponojmë, vërtetësia e të cilave përcaktohet nga gjykata. Për këtë arsye deri në momentin që gjykata të shprehet për vërtetësinë e dokumenteve jemi të detyruar të mos operojmë me vlerë fillestare të aktivitet. Korrigjimet në kontabilitet do të pasqyrohen në periudhat pasardhëse konform vendimit të gjykatës.

Përgjigja e grupit të auditëve. Për observimin e bërë sqarojmë se gjetja qëndron (është regjistruar si detyrim debitor kjo vlerë pa ndonjë akt administrativ). Rekomandimi i auditëve është që sektori i financës të mos e regjistrojë si detyrim debitor këtë vlerë por ta regjistrojë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, më vlerë fillestare dhe pas marrjes së vendimit të gjykatës të bëhen veprimet në kontabilitet. Për këto arsye, observimi i bërë nuk merret në konsideratë dhe nuk reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

Për inventarizimin e asetëve në vitin 2019, me urdhrin e titullarit nr.3, datë 15.01.2020, “Për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve“, është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga tre veta, (M. P. kryetar, A. S. e A. R. anëtarë). Në

këtë urdhër, përcaktohet që komisioni i mësipërm, duhet të kryejë inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre (aktive të qëndrueshme, inventar ekonomik, inventar i imët, etj), në depo dhe në përdorim.

Në zbatim të urdhrimit të mësipërm komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin fizik të aseteve mbi bazën e fletëve inventarëve të përpiluar nga sektori i financës. Për përfundimin e inventarizimit, komisionit i është caktuar afati deri me datën 10.02.2020 për hartimin e raportit përfundimtar për kryerjen e inventarizimit.

8.6. Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve.

Për periudhën e përfshirë në auditim (vitet 2018 dhe 2019), nga Institucioni i SHÇBA, nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve.

Sa më sipër, vlerësojmë se ne lidhje me sistemin e mbajtjes së kontabilitetit, menaxhimi dhe stafi i Institucionit ka punuar për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore që lidhen me këtë sistem. Transaksionet janë të kontrolluara e të regjistruara të rregullta, bilanci është nxjerrë dhe raportuar i kuadruar në kohë dhe është i bashkëshoqëruar me relacionin sqarues të vlerave të raportuara. Aktivitetet janë të administruara e të regjistruara në rregull, procedura këto që tregojnë se nga ana e Institucionit ka funksionuar kontrolli i brendshëm i sistemit.

10. Auditimi i organizimit dhe funksionimit të llogarive të sektorit material në shërbimet e Transportit, Veshmbathjes dhe Armatimit.

Nga auditimi në sektorin e transportit, rezultoi se ky shërbim, mbahet në institucionin e QSHAMT. Mjetet në përdorim të këtij institucioni, janë të mbajtura në kontabilitetin e QSHAMT. Gjithashtu i gjithë dokumentacioni për riparimin, mirëmbajtjejn, shpenzimet e karburantit, etj, janë në QSHAMT.

Trajtimi i punonjësve veshmbathje,

Për periudhën në auditim (viti 2018 dhe 2019), punonjësit e SHÇBA janë trajtuar për kompesim të veshmbathjes një herë në vit me një pagë bruto, sa masa e një page mujore e vendit të punës në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në MPB” dhe pikës 6 të VKM nr.776, datë 19.11.2014 “Për disa të drejta të punonjësve të SHÇBA në MB”. Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, titullari i institucionit ka nxjerrë në fillim të çdo viti urdhrin “Për kompensimin në vlerë lekë të veshjes civile” të punonjësve. Për vitin 2018 ka nxjerrë urdhrin nr.458, datë 27.02.2018 dhe për vitin 2019 nr.04, datë 10.01.2019 me disa ndryshime. Likuidimi është kryer me urdhërshpenzimi sipas urdhrimit të titullarit një pagë bruto si më poshtë:

Nr.	urdhërshpenzimi	Lista/Mujore	Nr./punonjësish	Pagë bruto/lekë
1.	nr. 37, 38, 39, 40, 41, dt 05.03.2018	Mars	18	1,629,079
2.	nr. 68, 69, 70, dt 05.04.2018	Prill	30	2,382,948
3.	nr. 85, 86, 87, dt 04.05.2018	Maj	23	2,131,645
4.	nr.108,109,110,111,112, dt 07.06.2018	Qershor	28	2,562,531
5.	nr. 132,133, 134, dt 05.07.2018	Korrik	14	1,234,519
6.	nr. 267, dt 21.12.2018	dhjetor	2	121,172
I	Nr.punonjësish përfitues vitin 2018		115	10,061,894
1.	nr.011,012, dt 11.01.2019	janar	6	543,011
2.	nr.40, 41, 42, 43, dt 12.03.2019	mars	17	1,532,421
3.	nr.66,67, 68, 69, dt 10.04.2019	Prill	35	3,003,918
4.	nr.93,94,95,96,dt 09.05.2019	Maj	25	2,272,423
5.	nr.125,126,127,128,dt 19.06.2019	Qershor	19	1,644,794
6.	nr.150,151,dt 08.07.2019	Korrik	15	1,368,754
7.	Nr.174, dt 07.08.2019	Gusht	1	121,000
7.	nr.212,213,dt 08.10.2019		8	697,611
	Nr.punonjësish përfitues vitin 2019		126	11,183,932

Gjetje: Nga auditimi dokumentacionit të trajtimit të punonjësve me një pagë bruto u konstatua se për vitin 2018, kanë përfituar 115 punonjës në vlerën 10,061,894 lekë dhe për vitin 2019, kanë përfituar 126 punonjës (nga 115 aktualisht në organikë pasi ka patur shumë emërimet dhe lirime) në vlerën 11,183,932 lekë, në total për dy vitet 21,245,826 lekë për të cilën nuk është mbajtur tatimi në burim në masën 15% në shumën 3,186,873 lekë, kjo në kundërshtim me nenin 8 pika 1/a, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me nenin 2 të ligjit nr.156/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me pikën 2.3 “Të ardhurat e tatueshme” të Udhëzimit të MF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Për sa i përket mos mbajtjes së tatimit në burim në masën 15% theksojmë se në të gjitha auditimet e mëparshme është konstatuar dhe është lënë rekomandimi përkatës që, “Menaxhimi i lartë i organizatës, sektori i buxhet financës, të regjistrojë si detyrim debitor vlerën e tatimit në burim për çdo person dhe menaxhimi i lartë i institucionit, të kërkojë interpretim ligjor nga Drejtoria Juridike dhe e Përafrimit të Legjislacionit në MPB dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Ministrinë e Financave”.

Në lidhje me këtë gjetje, nga ana e palës së audituar është bërë observim.

Observimi: “Referuar kësaj gjetje në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, Udhëzimit të MF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe ligjit nr.70/2014, “Për SHÇBA në MPB” neni 36 pika 1, **nuk jemi dakort pasi:**

1- Ligji 70/2014 neni 36 “Trajtim me veshmbathje” pika 1 shprehet se: “Punonjësi i Shërbimit trajtohet me veshmbathje një herë në vit, sa masa e një page mujore të vendit të punës, sipas kriterëve të përcaktuara me VKM”, pra **trajtohet me veshmbathje dhe jo shpërblehet apo përfiton të ardhura.**

2- Bazuar në strukturën e llogarive të Planit Kontabël Publik ky lloj shpenzimi kategorizohet në artikullin 602 mallra e shërbime të tjera, konkretisht në nënzërin 1001-**Uniforma e të tjera veshje speciale** dhe jo në artikullin 600 Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli, pra nuk klasifikohet si pjesë e pagës, shpërblim apo të ardhura të tjera të përfituar në lidhje me marrëdhënien aktuale të punës.

3- Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, si dhe në Udhëzimin e MF nr.5, datë 30.01.2006 të ndryshuar, në asnjë nen apo pikë të saj nuk përcaktohet që ky trajtim klasifikohet e ardhur dhe për këtë arsye duhet të tatonet. Arsyetimi juaj për klasifikimin e këtij kompensimi të shpenzimeve që bëjnë punonjësit për t’u pajisur me veshmbathje, si e ardhur për punonjësin është e pabazë pasi ju citoni pikën 2 të nenit 9 të ligjit 8438 i ndryshuar ku specifikohet se të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatonen me 15 për qind. Trajtimi me veshmbathje nuk është e ardhur pasi nuk shton të ardhurat e individit por kompenson një shpenzim të bërë nga punonjësi për t’u pajisur me veshmbathje si detyrim ligjor.

Pavarësisht se e kemi kundërshtuar gjetjen tuaj si të pabazuar në akte ligjore (siç cituam më lart) dhe nuk e kemi përfshirë në asnjë plan veprimi përjashtimisht në “Plan veprimin” e dërguar me nr.782/2, datë 29.05.2017, kemi pranuar të zbatojmë rekomandimin tuaj duke i kërkuar mendin zyrës Juridike të MB. Për këtë arsye me shkresë të posaçme i kemi përcjellë kërkesën për interpretim juridik të çështjes kësaj drejtorie, e cila ia ka adresuar Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, duke qënë se është çështje financiare dhe kërkonte interpretim nga profesionistë të fushës së financës. Me shkresën nr.3249/2, datë 09.06.2017 “Kthim përgjigje” Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është shprehur se;

“Ky trajtim nuk mund të përfshihet në zërin “Paga dhe shpërblime” dhe nuk mund të konsiderohet si e ardhur”.

Këtë përgjigje ia kemi vënë në dispozicion edhe Drejtorisë Tuaj, me anë të një shkrese të posaçme, e cila mesa duket nuk është marrë në konsideratë dhe vazhdon kembëngulja pa pasur një bazë ligjore.

Përveçse sa më lart, me shkresën nr.429, datë 03.03.2020 "Për dhënie mendimi" u kemi kërkuar interpretim të çështjes MFE si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Jemi në pritje të një përgjigje, në bazë të të cilës do të procedojmë dhe do t'ju vëmë në dijeni.

Përgjigja e grupit të auditëve. Për observimin e bërë sqarojmë se ; Paga bruto vjetore që ju është dhënë punonjësve të Shërbimit për kompensim veshmbathje, vërtet nuk është shpërblim por në fakt është e ardhur për punonjësit që e përfitojnë këtë pagë.

- Ky lloj shpenzimi, vërtet është i përfshirë në zërin e shpenzimeve 602, por kjo nuk do të thotë që nuk taten në burim asnjë nga shpenzimet e zërit 602. Po për marrjen ose dhënien me qira të objekteve, a duhet të përlllogaritet tatimi në burim?

- Për problemin që ju trajtoni se në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 dhe udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006, kjo pagesë nuk trajtohet si e ardhur që duhet të taten në burim qëndron. Por sqarojmë se në përjashtimin e të ardhurave që taten në burim, që janë të përcaktuara në udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006, nuk përfshihet e ardhura që përfitohet nga trajtimi i punonjësve me pagë për veshmbathje.

Nisur nga sqarimet e mësipërme, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MB, ka kërkuar në vazhdimësi që të kërkohet interpretim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pranë MFE, e mbi bazën e këtij interpretimi të bëhen veprimet përkatëse nga Shërbimi.

Theksojmë se institucioni Juaj, ka kërkuar mendim me shkresën nr.429 datë 03.03.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në MFE. Me ardhjen e sqarimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në MFE, të bëhen edhe veprimet përkatëse.

Për këto arsye, observimi i bërë nuk merret në konsideratë dhe nuk reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

Auditimi i sektorit të armatimit

-Auditimi i rregullshmërisë në plotësimin e dokumentave të lëvizjes së armatimit e municionit sipas kërkesave të përcaktuara dhe veçorive të mbajtjes së llogarisë për shërbimet e armatimit. Auditimi i librave të llogarisë së armatimit dhe rakordimi i llogarisë me inventarin fizik të armëve e municionit të administruar nga personeli.

Personeli i Shërbimit për SHÇBA, në zbatim të nenit 57 të ligjit 70/2014, "Për SHÇBA në MPB" ka të drejtën e mbajtjes së armëve dhe municionit. Për procedurën e paisjes me armë zjarri dhe mënyrën e administrimit të armëve, në zbatim të nenit 96 të ligjit nr.70/2014, MPB ka nxjerrë Urdhrin nr.300, datë 06.10.2014 "Për procedurat e paisjes së personelit me armë zjarri si dhe mënyrën e administrimit dhe përdorimit të tyre".

Administrimi i armatimit në këtë njësi kryhet nga specialist i armatimit (magazinieri), i cili përpilon fletëhyrjet dhe fletëdaljet për lëvizjen e armatimit e municionit dhe njëkohësisht kryen dhe regjistrimin e tyre në librin e llogarisë për shpërndarjen e armatimit për personelin. Ky libër është i numërtuar, i sekretuar dhe i protokolluar nga sekretaria e Institucionit.

Për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019, dokumentacioni bazë i lëvizjes së armatimit e municionit për hyrjet është (fletëhyrja nr.15 datë 09.01.2018 deri më nr.23 datë 15.11.2018 dhe nga nr.1 datë 13.05.2019 deri më nr.5 datë 28.06.2019 dhe nr.1 datë 19.09.2019 deri nr.6 datë 01.10.2019). Të gjitha fletëhyrjet, janë hyrje të brendshme (dorëzuar nga efektivat që janë larguar nga puna ose kanë kaluar në një detyrë tjetër).

Në një rast u gjjet që fletëhyrja nr.17 e përpiluar në vitin 2018, është përsëritur dy herë (kthim armatimi nga M. Sh. dhe nga E. M.).

Gjithashtu, në vitin 2019, janë përpiluar fletëhyrje me numër rendor nga 1 deri në 5 dhe nga 1 deri në 6, pra janë dubluar fletëhyrjet për këtë vit ushtrimor.

Për periudhën e audituar, dokumentacioni bazë i lëvizjes së armatimit e municionit për hyrjet është (fletëdalja nr.58 datë 09.01.2018 deri më nr.64 datë 11.07.2018 dhe fletëdalje nr.1 datë 19.03.2019 deri nr.6 datë 13.07.2019).

Gjetje: Fletëhyrjet e armatimit e municionit, për periudhën e audituar, nuk kanë numër rendor të saktë pasi janë dubluar numrat, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36 e tij ku përcaktohet që *“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vertetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaku dhe veprimin, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”*. Për këtë veprim ka përgjegjësi specialisti i armatimit.

Për armët e shpërndara në efektiv nga ana e sektorit të armatimit, është hapur libri model 35 *“Libri i shpërndarjes së armatimit në efektiv”*. Ky libër është i numërtuar dhe i sekretuar. Janë të shpërndara në efektiv gjithsej 32 armë, nga 43 armë që janë gjithsej në përdorim të këtij institucioni, (11 armë janë gjendje në magazinën e institucionit).

Nga verifikimi i këtij libri, rezulton se nuk kanë firmosur efektivat Ardian Ymeraj, Gerald Shahu dhe Dritan Pjetri.

Gjithashtu nuk kanë firmosur në librin model 35, ish efektivët Gjergji Koti, Muharrem Hoxha dhe Dritan Cule. Këto persona, janë larguar nga puna dhe kanë bërë dorëzimin e armatimit e municionit; Gjergji Koti me fletëhyrje e brendshme nr.1 datë 13.05.2019, Muharrem Hoxha fletëhyrje e brendshme nr.23 datë 15.01.2019 dhe Dritan Cule fletëhyrje e brendshme nr.3 datë 21.05.2019.

Gjetje: Në gjashtë raste, nuk është firmosur libri model 35, *“Libri i shpërndarjes së armatimit në efektiv”*. Në tre raste, punonjësit janë në marrëdhënie pune ndërsa në tre raste të tjera, punonjësit janë larguar nga puna dhe kanë bërë dorëzimin e armatimit dhe municionit. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e formatit të miratuar, *përgjegjësi e specialistit të armatimit*.

Sa sipër vlerësojmë se, nga auditimi i kryer në sektorin e armatimit dhe municionit në Institucionin SHÇBA, grupi i auditimit referuar gjetjeve të trajtuara në materialin e auditimit konkludon se, stafi që menaxhon këtë sistem, është i trajnuar, por shkeljet e konstatuara për zbatimin e Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, tregojnë se nuk është punuar në dokumentimin e lëvizjes së aktiveve për këtë sektor.

V. PLAN VEPRIMI I REKOMANDIMEVE TË AUDITIT.

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikën 4.1.12 të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, gupi i auditimit referuar gjetjeve të analizuara në këtë Raport Final Auditimi, paraqet rekomandimet sipas nivelit të prioritetit për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Gjetje: Nga 14 rekomandimet e lëna në auditimin e fundit të kryer për periudhën deri më 31.12.2017, përfshirë edhe rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme e të pazbatuara, struktura menaxhuese e SHÇBA, ka realizuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht ose në proces realizimi 4 rekomandime dhe nuk janë realizuar 5 rekomandime. Gjithashtu nga insitucioni, nuk është caktuar një punonjës për komunikuar, monitoruar dhe informuar, për progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Rekomandim 1: Institucioni i SHÇBA, përsa i përket rekomandimeve të lëna ne auditimet e mëparshme, të cilat janë të pranuar nga organizata, e të pazbatuara deri tani ose që janë në proces zbatimi, t'i marë në evidence dhe të anlizojë secilin prej tyre (siç janë trajtuar në këtë projekt raport). Organizata të hartojë program të veçantë pune, duke adresuar sipas funksioneve menaxheriale, personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimin e tyre, proceset dhe dokumentacionin përkatës për secilin nga këto rekomandime, si dhe afate kohore të përcaktuara qartë, për zbatimin dhe raportimin e tyre ne DAB. Për ndjekjen e gjithë këtij procesi nga drejtuesi i SHÇBA, të caktohet një nëpunës me pervojë dhe me përgjegjësi menaxheriale, për ndjekjen e këtij rekomandimi dhe të raportojë për progresin e bërë në zbatimin e tyre. Titullari i institucionit të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB.

Niveli i prioritetit: I Lartë

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Njësia publike SHÇBA, në kuadrin e funksionimin të sistemit të MFK, me gjithë përmirësimet e bëra nuk ka arritur që :

- Të krijojë një mjedis të plotë kontrolli, pasi që nga viti 2014 e në vazhdim, ka patur ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të strukturës dhe organikës së institucionit, por edhe ndryshime ligjore. Këto ndryshime nuk janë reflektuar në rregulloren e brendshme të veprimtarisë së këtij institucioni.

- Nuk është miratuar me urdhër të brendshëm të titullarit të njësisë publike, ngritja e grupit të menaxhimit strategjik, (GSM), si dhe nuk ka të përcaktuar kordinatorin e riskut të njësisë publike (personin përgjegjës) për bashkërendimin e veprimtarive të drejtorive, sektorëve e zyrave, që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve si dhe për raportimin e përgjithshëm të risqeve të institucionit te titullari i institucionit.

- Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të pasqyrohen objektiva të qarta lidhur me misionin që ka ky institucion, vlerësimi dhe kontrolli i risqeve në arritjen e objektivave. Nga ana e strukturave operacionale dhe strukturave të tjera të institucionit, nuk është implementuar akoma Manuali i MFK.

- Institucioni nuk ka arritur të kryejë sa dhe si duhet aktivitetin e kontrollit të brendshëm në vazhdimësi dhe në mënyrë të plotë, në të gjitha hallkat menaxhuese. Kjo pasqyrohet te moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna dhe i gjetjeve të konstatuara gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit, diferencat e inventareve, mosnxjerrja e përgjegjësive administrative për vendimet gjyqësore të formës së prerë, ndjekja e arkëtimit të detyrimeve debitorë, përpilimi i dokumentacionit bazë në sektorët e shërbimeve, etj.

Rekomandim 2: Menaxhimi i lartë, të marrë në analizë gjetjet e konstatuara për komponentët e kontrollit duke hartuar procedura të shkruara për eliminimin e problemeve të konstatuara dhe mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Të rishikojë rregulloren e brendshme të Instiucionit, për ta përshtatur me aktet ligjore që mbulojnë fushën e veprimtarisë së SHÇBA, strukturën aktuale të njësisë publike dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Gjithashtu institucioni të ngrëjë GSM, të hartojë regjistrin e riskut të njësisë publike dhe të përcaktojë kordinatorin e riskut të kësaj njësie.

Niveli i prioritetit: I Lartë

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Në muajin Nëntor të vitit 2019, është bërë ndërprerja e përfitimit të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 9 punonjës të shërbimit. Mbeshtetur në bazën ligjore e nënligjore që normon këtë shpenzim, rezulton se ndërprerja e këtij përfitimi, nuk është e bazuar.

Rekomandim 3: Menaxhimi i lartë, të marrë në analizë gjetjen e grupit të auditëve dhe duke ju referuar bazës ligjore të cituar në këtë Raport Final dhe të rishikojë mundësinë që të mos privojë punonjësit e kësaj organizate për përfitimin e trajtimit financiar për largësi, pa patur referencë ligjore. Përfitimi i pagesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, është e bazuar në dy VKM (nr.776 datë 19.11.2014 dhe nr.8259 datë 03.12.2014) dhe udhëzimin e MPB nr.675 datë 05.12.2014, akte në të cilat është shprehur që punonjësi, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, sipas distancave kilometrike.

Niveli i prioritetit: I Lartë

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Punonjësit që kanë përfituar trajtimin financiar për largësi kanë sjellë të gjithë dokumentacionin justifikues në datën e fillimit të trajtimit me largësi (vërtetimin e lëshuar nga njësi administrative për vendbanimin, të cilat shprehen mbi vendbanimin e familjes së punonjësit dhe mbi vendbanimin e vetë punonjësit të trajtuar me largësi, certifikata familjare, etj.) dokumentacion i cili nuk është rifreskuar deri në fund të vitit 2019.

Rekomandim 4: Menaxhimi i lartë i institucionit, të kërkojë nga punonjësit e shërbimit që trajtohen financiarisht me pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, të rifreskojnë dokumentacionin, pasi mund të ketë ndryshime të vendbanimit.

Niveli i prioritetit: I Mesëm

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Për periudhën e audituar, nga 719 autorizime të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA “Për angazhim me shërbim të punonjësve të SHÇBA jashtë vendbanimit të tyre”, janë protokolluar, pas kryerjes së shërbimit nga punonjësit 456 autorizime ose 63% e tyre.

Rekomandim 5: Nëpunësi autorizues, për çdo rast të dërgimit të punonjësve me shërbim brenda vendit, të përpilojë e miratojë autorizimin, ku të përcaktohet drejtimi i lëvizjes, kohëzgjatja, etj. Nëpunësi zbatues, të mos kryejë likuidimin e shpenzimeve për udhëtime e dieta, pa patur bashkëlidhur autorizimin e titullarit, të protokolluar përpara fillimit të shërbimit.

Niveli i prioritetit: I Mesëm

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Sektori i buxhet financës ka likuiduar me urdhërshpenzimi nr.215, 216, 217, 218 219, datë 11.10.2019, gjoba të paguara me vonesë nga institucioni në shumën 25,000 lekë nga buxheti i SHÇBA, gjobë për deklarim të vonuar punëmarës të rinj në vitin 2017 dhe 2019.

Rekomandim 6: Menaxhimi i lartë i institucionit, të marrë në analizë gjetjen dhe të përcaktojë personat përgjegjës, për likuidimin e këtyre gjobave.

Niveli i prioritetit: I Lartë

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.3419, datë 13.07.2017, me USH nr.235, datë 28.10.2019 është likuiduar përmbaruesi privat “Kodra Bailif Service shpk”, në shumën 292,628 lekë ku përfshihen edhe shpenzimet përmbarimore 26,400 lekë të likuiduara. Likuidimi është bërë pa patur faturën tatimore, (likuidimi datë 28.10.2019 fatura tatimore datë 01.11.2019).

Rekomandim 7: Menaxhimi i lartë i institucionit, të marrë në analizë gjetjen dhe të përcaktojë personin përgjegjës. Në të ardhmen, të mos kryhet asnjë likuidim zyrove përmbarimore, pa patur faturën tatimore.

Niveli i prioritetit: I Mesëm

Afati i zbatimit Menjëherë dhe në vijimësi.

Gjetje: Vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor prej 221,484 lekë, përfaqëson vlerën e mbetur të pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiVVifi” me vlerë fillestare 700,000 lekë. Nga dokumentacioni që disponon institucioni, nuk vertetohet që kjo paisje ka dalë në përdorim. Vlera e regjistruar në kontabilitet si detyrim debitor, nuk është e saktë.

Rekomandim 8: Menaxhimi i lartë i institucionit, të marrë në analizë gjetjen dhe të kërkojë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor i Shkallës së Parë Tiranë, avancimin e hetimeve për humbjen e pajisjes “Sistem regjistrimi UniFiVVifi” me vlerë fillestare 700,000 lekë.

Spektori i financës të mos e regjistrojë si detyrim debitor vlerën e mbetur prej 221,484 lekë, pasi nuk ka dokumente që kjo paisje është futur në përdorim në vitin 2014. Spektori i financës të regjistrojë në kontabilitet, në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, më vlerë fillestare pajisjen “Sistem regjistrimi UniFiVVifi”.

Niveli i prioritetit: I Lartë

Afati i zbatimit Menjëherë.

Gjetje: Nga auditimi dokumentacionit të trajtimit të punonjësve me një pagë bruto u konstatua se, për vitin 2018, kanë përfituar 115 punonjës në vlerën 10,061,894 lekë dhe për vitin 2019, kanë përfituar 126 punonjës (nga 115 aktualisht në organikë pasi ka patur shumë emëtime dhe lirime) në vlerën 11,183,932 lekë , në total për dy vitet 21,245,826 lekë për të cilën nuk është mbajtur tatimi në burim në masën 15% në shumën 3,186,873 lekë.

Për këtë gjetje të grupit të auditëve, nuk lëmë rekomandim pasi është një rekomandim i përsëritur disa herë. Organizata të zbatojë rekomandimin e parë të kapitullit V, “Plan veprimi i rekomandimeve të auditit”.

Në zbatim të nenit 12 pika d, të “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikave: 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, 4.1.13 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, nga ana Juaj të hartohet dhe të miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe të dërgohet zyrtarisht në DAB në MB, jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga marrja e këtij Raporti Final.

Nëse nuk sillet Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve me persona e afate konkrete, jemi të detyruar në zbatim të pikës: 4.1.13.1 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, të MAB të informojmë Ministrin, mbi mospërmbushjen e përgjegjësisë ligjore të menaxhimit të lartë të subjektit të audituar.

Në zbatim të pikës 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” të MAB, Drejtuesi duhet të caktojë një punonjës me përvojë që të evidentojë rekomandimet e lëna, të komunikojë, të monitorojë dhe të informojë vazhdimisht DAB në MB mbi zbatimin e rekomandimeve deri në zbatimin e plotë të tyre.

GRUPI AUDITIMIT

Hamdi ÇOBAJ

Natasha URUÇI